

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7746 E shtunë 22 Dhjetor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **i** Ditës
Më 19 dhjetor, Përfaqësuesja e Lartë e BE-së, Mogherini mblo dhi liderët e Ballkanit Perëndimor në një takim informal në Bruksel. Pa mohuar ...
Vijon në faqen 20

Nga JORGJI KOTE
Shumë samite, pak rezultate


Opinion **i** Ditës
Forcat populiste u kthyen fuqishëm në Europë në vitin 2018, duke marrë pushtetin në Itali dhe duke u konsoliduar në vende si Hungaria dhe Polonia ...
Vijon në faqen 21

Nga HENRY RDIGEWELL
Drejtimi që do të marrë populizmi në Europë në vitin 2019




Tension në parlament, përplasje PS-PD

Rrëzohet vetingu, Basha shan Ballën dhe kërkon ndjesë. Byroja "fal" Berishën

Ish-kryeministri: Rrëmbeni armët. Votohet Ridvan Bode në BSH, PD: Eshtë i Ramës

Kuvendi rrëzoi dje me shumicë votash propozimin e grupit parlamentar të Partisë Demokratike për vetingun në politikë. Ndryshimet e propozuara morën vetëm 52 vota nga deputetët e opozitës, si dhe 74 vota kundër të deputetëve të majtë. Në këtë mënyrë bie edhe një nga kërkesat kryesore që opozita e kishte kthyer në një nga objektivat ...
Në faqen 3

KESHILLI BASHKIAK: LISTA PERFUNDIMTARE ME PERFITUESIT DHE AFATET

VENDIMI, 1100 FITUESIT QE MARRIN KREDI TE BUTE

Kur do të futet në zbatim vendimi i këshilltarëve të Tiranës për programin social "Subvencionimi i interesave të kredisë për 2018"



(Në foto) Kryetari i Bashkisë së Tiranës Erion Vellaj duke folur në mbledhjen e Këshillit Bashkial

FLET DREJTORESHA
ATP: Pronarëve që u ndahen 138 mln lekë për kompensimin e pronave, lista
Në faqen 6

KRYEBASHKIAKU
Vellaj: Basha dhe Tabaku i dhanë leje ndërtimi vetes së tyre
Në faqen 5

PROCESI NE KATANIA
Dëshmia e italianit të arrestuar: Si kryenim trafikun e marijuanës me Moisi Habilajn
Në faqen 8

"VRASJE ME PARAMENDIM"
Masakra e Mamurrasit me 1 të vrarë e 2 të plagosur, babai i viktimit: Dua drejtësi
Në faqen 9

INSTA-MANIA, BEBET VIP ME RRJETE SOCIALE



Festivali i RTSH, lufta e fortë mes Soni Malaj dhe Jonida Maliqit
Suplement

Fabiola Hysenbelliu uron vogëlushët: Qofshi të lumtur këtë vit të ri e gjithmonë

'Hysenbelliu Group', dhurata fëmijëve jetimë e me aftësi ndryshe

Fatmir Hysenbelliu: Të ndihmojmë sadopak të gjithë shqiptarët

Nga VOLTIZA DURO

Në muajin e festave të fundvitit, 'Hysenbelliu Group' ka surprizuar me qindra dhurata fëmijët jetimë nga mbarë vendi, si dhe ata me aftësi ndryshe. Duke vijuar traditën e përvitshme të bamirësisë, zv presidentët e



këtij rrjeti të fuqishëm biznesesh, kanë shpërndarë kartolina, dhurata dhe kanë falur shumë buzëqeshje e dashuri për vogëlushët. Zv presidentja e 'Hysenbelliu Group', Fabiola Hysenbelliu, është shprehur tejet e kënaqur që ndodhet pranë fëmijëve ...
Në faqen 7

Në faqen 9

KUVENDI DEBATET

Valentina Madani

Parlamenti zhvilloi djehnjë seance maratone jashtë radhe, lidhur me amendamentin kushtetues të opozitës për vetingun e politikanëve. Ish-kryeministri Sali Berisha kërkoi votimin e këtij ndryshimi kushtetues, pasi në të kundërt do ta bëjnë vetë shqiptarët, që protestojnë vetingun. I ashpër në paralajmërimin e tij për mazhorancën, Berisha nga foltorja e parlamentit paralajmëroi shumicën të pranonte amendamentet kushtetuese për vetingun në politikë, ose përndryshe do të shkudeshin nga karriget. Në këtë rast i erdhën në ndihmë vargjet rilindase "o djem rrëmbeni armët, ja vdekje ja liri". Sipas tij, nëse mazhoranca nuk voton vetingun në politikë, do të përballen me "djemtë që do rrëmbejnë armët" në rrugët e Shqipërisë. "Momenti është kritik. Ju them se mund të bëni një gabim, më të rëndin që keni bërë ndonjëherë, nëse përdorni kartonët e zinj, të nxira të kimit siç i keni. Në rast se ju përdorni sot këtu diktatin e kimit, si përfaqësues të tij, për të hedhur poshtë këtë amendament, i cili do të bënte historinë për shqiptarët, ju garantoj se forca do t'ju shkudë nga kjo karrige. Përndryshe bëhuni gati në rrugë dhe në sheshet e Shqipërisë do të ushtojë, 'o djem rrëmbeni armët, ja vdekje, ja liri'. Kjo do jetë", theksoi z. Berisha.

KËRKESA
Pas deklaratis së fortë të ish-kryeministrit Berisha, reagoi kreu i qeverisë, Edi Rama. Kryeministri i vendit i është përgjigjur me ironi Berishës, përmes një postimi në "Twitter". "Për vezet e për glasat e kotecit të Saliut unë rroj 1 mijë vjet, po më vjen të qaj për shturjen verbale, që ai dhe kakërdhitë e tij u kanë ngjitur plot të rinjve dhe të ulëras për Shqipërinë, që turpërohet ekraneve të Europës me pamjet e parlamentit të kthyer në një show pularie", shkruan z.Rama. Për recitimin e vargjeve rilindase nga z.Berisha, socialistët kërkuan nga Byroja e Kuvendit të merren masa për thirrje antikushtetuese. Kryetari i parlamentit, Gramoz Ruçi kërkoi nga grupi parlamentar i PD-së që të distancohet nga këto thirrje. "Zoti Berisha, është hera e dytë që e përmendi këtë shprehjen e partizanëve legjendarë, e rilindësve aq më mirë, por e përdorur nga një ish-kryeministër dhe ish-president 'o djem rrëmbeni armët, ja vdekje, ja liri', sigurisht është e papranueshme, është e dënueshme dhe duhet të distancohen të gjitha grupet parlamentare", tha Ruçi. Sipas tij, "thirrja patriotike, o djem

Reagon Rama: Unë rroj 1 mijë vjet, por më vjen të qaj për shturjen verbale

Vetingu, Berisha-socialistëve: Votoni ose "O djem, rrëmbeni armët"

Ruçi: Distancohuni! Paloka e Spaho: Është këngë...



Ish-kryeministri Sali Berisha

SALI BERISHA

"Nëse përdorni kartonët e zinj për të hedhur poshtë këtë amendament, i cili do të bënte historinë për shqiptarët, atëherë ju garantoj se forca do t'ju shkudë nga kjo karrige. Përndryshe bëhuni gati në rrugë dhe në sheshet e Shqipërisë do të ushtojë, 'o djem rrëmbeni armët, ja vdekje, ja liri'. Kjo do jetë", tha Berisha.

EDI RAMA

"Për vezet e për glasat e kotecit të Saliut unë rroj 1 mijë vjet, po më vjen të qaj për shturjen verbale, që ai dhe kakërdhitë e tij u kanë ngjitur plot të rinjve dhe të ulëras për Shqipërinë, që turpërohet ekraneve të Europës me pamjet e parlamentit të kthyer në një 'show pularie', shprehet kryeministri i vendit.

Gjatë një seance parlamentare



Thirrja e Berishës, Shehi qetëson socialistët: Rrini të qetë, s'ka për të marrë njeri armët

Kreu i LSHK-së, Dash Shehi deklaroi dje në Kuvend se pavarësisht pasionit të Berishës dhe thirrjes së bërë, askush nuk ka për të marrë armët. "Rrini të qetë se nuk ka për të marrë njeri armët, ishte koha për të marrë armët dhe ne kemi bërë me letra, rrini rehat, përtej pasionit të Berishës, nuk ka për të ndodhur", tha ai. Shehi foli me tone të forta dhe pa doreza në seancën e djeshme parlamentare. Shehi iu dha përgjigje socialistëve, të cilët nuk lanë rast pa u kujtuar opozitarëve, sipas tyre, zullumet që kanë bërë në kohën e qeverisjes së tyre. "Këtu jeni 5 vjet e gjysmë, gjykatësit e keni pasur, policët i keni pasur, hetuesit i keni pasur, i kishit futur në burg ata që do të



kishit futur nga ky krahu, që të mos keni me ç'a të mbuloheni më. Po ky është një sistem i vjetër korruptiv, që kush vjen prapa, qit një letër, se kam dy letra unë për ty. Kush ka letra nga ky krahu, kush e meriton le të hyjë në burg. Jo t'i fshihni ju për të mbuluar tuajat. Ky është realiteti normal në Shqipëri.

DASHAMIR SHEHI

"Rrini të qetë se nuk ka për të marrë njeri armët, ishte koha për të marrë armët dhe ne kemi bërë me letra. Rrini rehat, përtej pasionit të Berishës, nuk ka për të ndodhur", - tha deputeti Shehi.

Paskan qenë të korruptuarit këtu? Hajde t'i pastrojme të korruptuarit. Ndërsa ju keni qejf vetë, sepe ky është jorgani juaj. Se meqë disa këtu mund të kenë bërë zullume, mund të bëni të gjithë ju zullume duke qëndruar rehat. Kjo është teknike e vjetër: Unë që kam vitë në këtë sallë, sa herë xhiron shteti, kjo për-

doret. Ata përpara nesh ishin më të këqinj se ne. Jo nuk është ashtu, gjithsekush duhet të mbajë pjesën e vet. Nëse këtu ka të korruptuar, nxirreni, i keni të gjitha në dorë. Pse nuk i nxirrni? Sepse ajo është batanija që ju mban ngrohtë", - tha prë ai. Sipas Shehit, drejtësia i ka të gjitha mundësitë. "Asnjë nuk është aq i pasur sa të blejë të kalumen e vet, ai që vjen nga llumi në llum do shkojë, nuk kanë për ta bërë kurrë të rëndësishëm, të ndershëm, kanë hyrë e kanë dalë plot, ditën që janë bërë pis, i keni cepave të Tiranës, para mund të kenë, por fytyrë nuk kanë më", deklaroi deputeti Dashamir Shehi.

rrëmbeni pushkët, qoftë për pushtuesit osmanë, qoftë edhe pushtuesit gjermanë është kënduar nga atdhetarët dhe nga ne që jemi këtu. E përdorur në leksikon e debatit parlamentar në kontekstin e sotëm, është e papranueshme dhe duhen distancuar. Grupi PS ka bërë një kërkese që byroja do ta shqyrtojë". Fill pas Ruçit, kreu i grupit të PD-së, Taulant Balla kërkoi ndërprerjen e seancës dhe ka kërkuar që

të merren masa ndaj deputetit Sali Berisha, për thirrje antikushtetuese në parlament. "Kërkoj që të merren masa ndaj deputetit Sali Berisha për thirrje antikushtetuese në parlament", tha Balla.

DEKLARATA
Nënkryetari i PD-së, Edi Paloka bëri të ditur se Berisha citoi vargjet e një kënge patriotike. "Është këngë patriotike e kohës kundër turqve, jo si thatë ju këngë

partizane, me tekst të Thanas Floqit. Sa për pjesën tjetër, të jeni të bindur ju dhe ai që keni në krye se sot është vërtetë akt patriotik largimi një orë e më parë dhe çdo mënyrë e këtij që kemi kryeministër dhe kujdo që do ta mbështesë atë. Përgjastoni kë të doni, ky kryeministër do qërohet, më kot lodheni dhe bëni presion, nuk trembim më askënd. Në të njëjtën linjë ishte edhe nënkryetari

tjetër i PD-së, Edmond Spaho: "Vargjet e një kënge patriotike i konsideroni si thirrje për rrëzimin e rendit kushtetues. E keni kthyer në byro partie, ku propozoni të përjashtoni, po të kishit mundësi edhe gjithë grupin e opozitës. Nuk do arrini dot të mbyllni gojën e opozitës, do na keni kundër jush, jeni bërë e keqia më e madhe që vendi ka pasur. Derisa ju të shporreni, ne do të na keni këtu në këmbë".

PS 'fal' Berishën dhe Bashën, Byroja e Kuvendit përjashton Noken e Strazimirin

Byroja e Kuvendit vendosi dje të mos pezullojë nga seancat kreun e PD, Lulzim Basha si dhe ish-kryeministrit Sali Berisha për shkak tensioneve dhe gjuhës së përdorur në Kuvend. Vasilika Hysi tha Byroja ka vendosur t'i tërheqë vëmendjen Bashës dhe Berishës, ndërsa kërkese e PD për kryeministrit Edi Rama është rrëzuar. Sakaq deputetët e PD, Gent Strazimiri dhe Flamur Noka janë përjashtuar me 10 ditë nga seancat e Kuvendit. "U diskutua dhe u vendos tërheqja e vëmendjes për Lulzim Bashën dhe për deputetin Sali Berisha, duke pasur parasysh edhe moshën për Berishën. Kërkojmë që Berisha t'i japë fund gjuhës së përçarjes ndaj shqiptarëve në seancat e radhës. Kërkesa për deputetin Edi Rama rezultoi se nuk përbante gjunë të urrejtjes apo shkelje të etikës dhe kërkesa është rrëzuar Flamur Noka dhe Gent Strazimiri janë përjashtuar për 10 ditë nga seancat dhe komisionet parlamentare"- tha Vasilika Hysi.



Mazhoranca qeverisëse hedh poshtë nismën e PD-së për kontrollin e politikanëve

Kuvendi rrëzon vetingun, Basha flet me emra: Ja kush preket prej tij

Balla: Vetingun do e bëjë SPAK dhe Byroja e Hetimit

Kuvendi rrëzoi dje me shumicë votash propozimin e grupit parlamentar të Partisë Demokratike për vetingun në politikë. Ndryshimet e propozuara morën vetëm 52 vota nga deputetët e opozitës, si dhe 74 vota kundër të deputetëve të majtë. Në këtë mënyrë bie edhe një nga kërkesat kryesore që opozita e kishte kthyer në një nga objektivat e saj politike për të pastruar politikën nga individë të inkriminuar dhe që kanë përfituar pasuri në mënyrë të paligjshme. Gjatë fjalës së tij në Kuvend, kryetari i PD-së, Lulzim Basha ka folur me emra konkret deputetësh dhe politikanësh që sipas tij shpëtojnë nga rrëzimi i kësaj nisme.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

EMRAT
"Kemi një deputet Ergys Çyrbja që është konfirmuar që është pjesë e bandave. Kemi Fatmir Xhafajn që ndihmoi vëllain e tij. Kemi atë që do të flasë pas meje që ka thënë se ka një mik trafikant. Kemi Alket Hysenin që ka rrembyer toka në Dhërm. Kemi Arben Ahmetajn dhe Damian Gjoknurin, kemi Dakon e 339. Kemi Saimir Habilajn dhe natyrisht kreun e kësaj pune Edi Ramën".

SHKURT

Meta: Vetingu në politikë domosdoshmëri, të gjendet mënyra për t'u realizuar

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, komentoi dje nga Pogradeci, propozimin e opozitës për vetingun në politikë. Meta theksoi se vetingu në politikë është mjaft i rëndësishëm dhe duhet gjetur mënyra për ta realizuar atë. Sipas tij ndarja e politikës nga krimi është një domosdoshmëri. "Vetingu në politikë është i domosdoshëm. Duhet gjetur mënyra për ta realizuar vetingun në politikë", deklaroi Meta. Kujtojmë që sot mazhoranca rrëzoi kërkesën e opozitës për veting në politikë. Ndërkohë kreu i shtetit u bëri apel palëve që të gjejnë sa më shpejt dakordësinë për Reformën Zgjedhore. "Palët të gjejnë marrëveshjen për Reformën Zgjedhore. Marrëveshja për të kthyer besimin tek zgjedhjet e lira dhe të ndershme. Jemi të vonuar në Reformën zgjedhore", u shpreh Meta. Gjithashtu Meta komentoi edhe vendimin e qeverisë për dëbimin e ambasadorit të Iranit nga vendi jonë. "Aprovoj vendimin për dëbimin e ambasadorit iranian", tha kreu i shtetit. Më tej Meta deklaroi edhe njëherë se duhen plotësuar kërkesat e studentëve pasi ato janë të drejta dhe legjitime. "Kërkesat e studentëve të marrin përgjigje. Kërkesat e studentëve janë të drejta dhe legjitime. Studentët të kthehen në auditore të mos ikin nga vendi", përfundoi kreu i shtetit shqiptar.

Majko: Vetingu qesharak, të merremi me studentët, janë shpëtimi ynë

Ministri për Diasporën, Pandeli Majko, e ka konsideruar qesharake nismën e opozitës për vetingun e politikanëve, ndërsa theksoi se ajo me të cilën duhet të merret tashmë politika janë studentët. Ai i ka bërë apel opozitës të merren me studentët, pasi nuk janë kundërshtarë, por shpëtimi. "Lëvizja studentore është një paralajmërim serioz për politikën që filloi me lëvizjen studentore, është rritur numri i njerëzve që nuk dinë t'i shpjegojnë dallimet mes nesh. Dje u hodhën vezë në emër të studentëve, me shumë dënjitet kanë qenë studentët që janë distancuar nga çdo akt dhune. Çdo gjë që ka një fillim e ka një fund, nëse kjo lëvizje po na kujton këtë kjo kërkon reflektim dhe jo bërjen e trimit në Kuvend. Vetingu i politikës është vazhdim i kapitullit depersonalizues dhe fyes, politikanë duhet të provojë se nuk është i lidhur me krimin, mbi bazën e kësaj logjike shpëton vetëm ai që sjell prova", - deklaroi Majko. Ai shtoi se vetingu është qesharak. "Pafajësia e çdo individi jepet vetëm nga gjykatat nga askush tjetër, imagjini se gjendet politikan fajtor, ka ndodh, iken në burg, ka bëjnë komisionerët apo i dërgojnë për riedukim? Ky nuk është pastrim, por turpërim publik i saj", - tha ai.

DEBATI

Seanca e djeshme është shoqëruar me një debat të gjatë mes deputetëve të të dyja kraheve. Kështu, që në fillim të këtij diskutimi përfaqësuesit e opozitës kërkuan që Kuvendi të mos rrëzonte këtë nismë, por ta shtynte diskutimin e saj në kohë deri sa të gjendeshin mekanizmat e duhur për të reflektuar gjithë shqetësimet apo paqartësitë që shprehte Komisioni i Venecias në opinionin e vet rreth këtyre ndryshimeve. Por kjo kërkesë nuk është marrë parasysh nga socialistët, të cilët kanë këmbëngulur se opinionin e Komisionit të Venecias ishte i qartë dhe se nisma në fjalë binte ndesh jo vetëm me Kushtetutën, por edhe me konventat ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut. Kreu i grupit parlamentar të PS, Taulant Balla u shpreh se nisma e opozitës është absurde, pasi procesi i vetingut bëhet përmes zgjedhjeve dhe institucioneve të drejtësisë duke iu referuar ngritjes së SPAK dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit. "Jemi të gatshëm të votojmë së bashku reformën zgjedhore si reforma kyçe që kemi përpara dhe që lidhet edhe me vetingun në politikë, sepse vetingu në politikë ka vetëm dy institucione: zgjedhjeve dhe përmes drejtësisë. Nuk ka politikan të korruptuar që mund të ikë. Ky nuk merret fare me pasurinë e politikanëve, as me familjarët, as me politikanët direkt të lidhur me krimin", -tha Balla në emër të mazhorancës.

OPOZITA

Ndërkohë që kryetari i PD-së duke folur në këtë seancë, foli me emra konkret se cilët ishin politikanët që i tremben vetingut në politikë. "Sot nga kjo sallë një veting do të bëhet, sot nga kjo sallë do të kuptohet se cilët kanë frikë që t'i nënshtrohen kontrollit. Kemi një deputet Ergys Çyrbja që është konfirmuar që është pjesë e bandave. Kemi Fatmir Xhafajn që ndihmoi vëllain e tij. Kemi atë që do të flasë pas meje që ka thënë se ka një mik trafikant. Kemi Alket Hysenin që ka rrembyer toka në Dhërm. Kemi Arben Ahmetajn dhe Damian Gjoknurin, kemi Dakon e 339. Kemi Saimir Habilajn dhe natyrisht kreun e kësaj pune Edi Ramën", - u shpreh Basha. Por për t'i dhënë një mundësi nismës që të miratohej, ai i ka ofruar shumicës qeverisëse edhe një konsensus. Ai ka ofruar mundësinë që nëse mazhoranca do votojë vetingun, opozita ishte e gatshme që të votonte ligjet që do të bëheshin nga shumica për zbatimin e saj. "Ju nuk e doni vetingun, sepse për shumë do cenonte fundin e karrierës politike, por nga ana tjetër do ishte çlirim i këtij parlamenti dhe Shqipërisë nga krimi. Apeli është të bashkoheni me ne që të votojmë amendamentet kushtetuese, por ligjet bëjini vetë dhe ne do të votojmë me një kusht që të propozimet tuaja të jenë konsultuar me Komisionin e Venecias. Nëse votoni sot amendamentet kushtetuese, sillni propozimet tuaja dhe ne do t'i votojmë", -tha Basha.

DEGJENERON DEBATI NË KUVEND, BASHA KËRKON FALJE PËR FJALORIN

Lulzim Basha: Sot nga kjo sallë një veting do të bëhet, sot nga kjo sallë do të kuptohet se cilët kanë frikë që t'i nënshtrohen kontrollit. Kemi një deputet Ergys Çyrbja që është konfirmuar që është pjesë e bandave. Kemi Fatmir Xhafajn që ndihmoi vëllain e tij. Kemi atë që do të flasë pas meje që ka thënë se ka një mik trafikant. Kemi Alket Hysenin që ka rrembyer toka në Dhërm. Kemi Arben Ahmetajn dhe Damian Gjoknurin, kemi Dakon e 339. Kemi Saimir Habilajn dhe natyrisht kreun e kësaj pune Edi Ramën.

Taulant Balla: Jemi të gatshëm të votojmë së bashku reformën zgjedhore si reforma kyçe që kemi përpara dhe që lidhet edhe me vetingun në politikë, sepse vetingu në politikë ka vetëm dy institucione: zgjedhjeve dhe përmes drejtësisë. Nuk ka politikan të korruptuar që mund të ikë. Ky nuk merret fare me pasurinë e politikanëve, as me familjarët, as me politikanët direkt të lidhur me krimin. Nëse votoni sot amendamentet kushtetuese, sillni propozimet tuaja dhe ne do t'i votojmë.

Lulzim Basha: Ju nuk e doni vetingun, sepse për shumë do cenonte fundin e karrierës politike, por nga ana tjetër do ishte çlirim i këtij parlamenti dhe Shqipërisë nga krimi. Apeli është të bashkoheni me ne që të votojmë amendamentet kushtetuese, por ligjet bëjini vetë dhe ne do të votojmë me një kusht që të propozimet tuaja të jenë konsultuar me Komisionin e Venecias. Nëse votoni sot amendamentet kushtetuese, sillni propozimet tuaja dhe ne do t'i votojmë.

Taulant Balla: Kam një dosje, do ta jap kur të mbarosh. Çdo ditë t'i shikon për të lakuar banorët e Unazës me këtë makinë. Kjo tregon lidhjen vend me kompaninë Victoria Invest, dhe të kujtoj që dhe një nga vajzat e tua e ka emrin Viktoria. Janë arsyet e kumbarlëkut, kumbare e familjes tënde. Ngrije kokën ngrije.

Lulzim Basha: Jemi të instinkti i parë është instinkti i prindit dhe për atë që bëre këtu instinkti i parë ishte të të fusja një grusht, por u ndala nga dy gjëra. E para e punës, që të prekësh muajt, bëhesh vetë pis. E dyta, nuk do të arrija dot t'u përcilla qytetarëve arsyet pse ju nuk votoni vetingun e politikanëve. Automjeti im prej 6 vjetësh është në listë nga kompania "Mektrin", kompani shumë e mirë, meqë më dhe rastin t'i bëj reklamë. Nuk është as e ndonjë oligarku, as e ndonjë banditit, është enjë durraku të ndershmëri. Për, makina ime është 6 vite me listë, nga kompania Mektrin, o mashtues i certifikuar.

Pas seancës Basha nëpërmjet një statusi në rrjetet sociale kërkoi falje për fjalorin e përdorur. "Është nderuar bashkëqytetarë, ju kërkoi ndjesë për fjalorin e papërshtatshëm sot në Kuvend. Mbi vetëpërbajtjen si politikan triumfoi instinkti i prindit. Të shpifësh duke përmendur fëmijë të mitur, për të mbrojtur veten nga lidhjet me krimin është niveli më i ulët i politikëbërjes".

Njoftim për shitje me ankand të dytë

Shoqëria "Power & Justice" (PJ) sh.p.k. bazuar në adresën 577, 568 të Pr. Civilit ka shpallur shitjen me ankand të dytë për pasurinë e paligjshme të palës debitore "SH" Eksport Beton Luzhë sh.p.k. etj.

*** Tokë Arë" në Z. K. 1987 me numër pasurie 3038. Volumi 19 Faqe 71, me sipërfaqe 1000 m2 me cmin fillestar prej 50.016 Euro.

*** Tokë Arë" në Z. K. 1987 me numër pasurie 4056. Volumi 11 Faqe 92, me sipërfaqe 1730 m2 me cmin fillestar prej 100.368 Euro.

*** Tokë Arë" në Z. K. 1987 me numër pasurie 2573. Volumi 15 Faqe 239, me sipërfaqe 2000 m2 me cmin fillestar prej 98.112 Euro.

Ankandë vendosur hapet për 15 ditë dhe do të zhvillohet në datën 14.01.2019 në orën 15.00, pranë selisë në Bulevard "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kat 2, Zyrë nr. 5. Ofruesit mund të kontaktojnë 067282543 dhe vizitohen faqen WEB www.powerjustice-al.com.

BANKA E SHQIPËRISË

DEBATI

Opozita kundërshtoi zgjedhjet në Këshillin Mbikëqyrës të BSH-së si antikush-tetuese

Këshilli i BSH-së, PD: Ritvan Bode nuk është i yni, por i kryeministrit

"Të thuash që Bode do i bëjë hije qeverisë, kjo është turp"

Krijimi i Këshillit të ri të Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë është bërë dje objekt i një debati të gjatë mes mazhorancës dhe opozitës. Shkak është bërë votimi i një anëtarësi nga ana e mazhorancës i gjashtë anëtarëve të rinj të Këshillit Mbikëqyrës të BSH-së. Opozita ka kundërshtuar fort votimin e parlamentit, duke theksuar se mënyra se si kanë ardhur kandidaturat është antikush-tetuese dhe tregon qartë tentativën e mazhorancës dhe të kryeministrit për të kapur institucionin më të rëndësishëm kontrolues financiar në vend. Kryetari i grupit parlamentar të Partisë Demokratike, Edmond Spaho theksoi se në rastin e propozimeve për këtë këshill nuk është respektuar tradita e mëparshme, ku emrat vinin nga të gjitha forcat kryesore politike në vend. "Kryeministri po tenton të kapë edhe institucionin e fundit, atë të Bankës së Shqipërisë. Ka pasur një traditë në vend që kushdo që kanë qenë në pushtet, majtas ose djathta, kandidaturat janë shpërndarë në mënyrë proporcionale. Ju në mënyrë totalitariste e keni futur këtë në rend të ditës, ndaj e kundërshtojmë dhe votimin që është bërë dje edhe veprimin që kërkoni të bëni sot", tha Spaho. Ndaj këtij pretendimi reagoi kryetari i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla, i cili u shpreh se opozitës i ishte bërë thirrje disa herë që të bëheshin pjesë e këtij procesi për të mos e lënë një institucion të tillë që të futet në krizë, meqë anëtarëve të Këshillit të BSH-së u kishte mbaruar mandati. "Grupi parlamentar i PS-së ju ka bërë disa herë thirrje edhe ty si kryetar grupi, edhe zonjës si nënkryetare Kuvendit. Nëse ju do të kishit përgjigjur një nga ato kandidatúra, bujrum ta kishit sjellë. Nuk e keni sjellë zotëri", tha Balla. Nga ana tjetër, ai ka sqaruar se askush nuk mund të akuzojë PS-në se po



Ish-ministri i Financave Ritvan Bode

KANDIDATËT E PROPOZUAR NGA KUVENDI

1. Artan Hoxha
2. Arben Malaj
3. Luljeta Minxhozi

KANDIDATËT E PROPOZUAR NGA KRYEMINISTRIA

1. Suela Popa
2. Edlira Luçi
3. Ridvan Bode

DEKLARATA

BALLA
"Sa u përket kandidatëve të qeverisë, qeveria është tërësisht autonome në zgjedhjet e veta. Kryeministri ka zgjedhur dy, pra jo një kandidatë nga PD. Të thuash që unë kam çuar Ritvan Boden që bashkë me Edi Ramën të kapë Bankën e Shqipërisë, kjo është turp. Nuk mund të vijë dita që Oerd Bylykbashi t'i bëjë gjyqin Ritvan Bodes".



BYLYKBASHI
"Kjo është një shkelje flagrante e Kushtetutës. Ju kërkoni të kapni edhe pushtetin që do t'ju kontrollojë ju nëse bëni maskarallëqet me financat apo jo. Çdo lloj veprimi që do të çojë kapjen e Bankës së Shqipërisë në dorën e një force politike është thyerje e Kushtetutës. Ligji është i qartë që propozimet nuk vijnë nga një institucion".



Kush janë anëtarët e rinj të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë

Kuvendi votoi dje dhe sot 6 emrat e rinj të Këshillit Mbikëqyrës të Shqipërisë, duke plotësuar kështu vendet vakante të mbetura pas mbarimit të mandatit të anëtarëve të mëparshëm. Bëhet fjalë për tri kandidatë të propozuar nga qeveria dhe tri të propozuar nga Kuvendi. Më konkretisht, qeveria propozoi emrat e Suela Popës, e cila është bashkëshortja e deputetit të Lëvizjes Socialiste për Integritim, Vangjel Tavo. Gjithashtu, Këshilli i Ministrave propozoi emrin e ish-ministrit demokrat, Ridvan Bode. Të dyja këto propozime janë bërë nga Këshilli i Ministrave në mungesë të bashkëpunimit nga ana e Partisë Demokratike për të plotësuar me anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, kjo si një praktikë e mirë e ndjekur herët e mëparshme. Ndërkohë që kandidatúra e tretë e propozuar nga Këshilli i Ministrave është ajo e Edlira Luçit, një e afërme e zëvendësministrit të Financave, Erjon Luçi. Ndërkohë që Kuvendi me një praktikë të pandjekur më parë, mbështeti me 28 firma 3 kandidatúra të tjera në bllok dhe më konkretisht ish-ministrin socialist të Financave, Arben Malaj, Luljeta Minxhozin, bashkëshorten e ish-deputetit socialist, Qemal Minxhozi, aktualisht ambasador i Shqipërisë në Kosovë dhe juristin Artan Hoxha.



kap këtë këshill, pasi dy nga kandidaturat e propozuara nga qeveria janë të opozitës. "Sa u përket kandidatëve të qeverisë, qeveria është tërësisht autonome në zgjedhjet e veta. Kryeministri ka zgjedhur dy, pra jo një kandidatë nga PD. Të thuash që unë kam çuar Ritvan Boden që bashkë me Edi Ramën të kapë Bankën e Shqipërisë, kjo është turp.

Nuk mund të vijë dita që Oerd Bylykbashi t'i bëjë gjyqin Ritvan Bodes, ta thotë që e kemi kapur ne Ritvan Boden, kur Bode ka qenë ministër në dy qeverisje të PD", tha Balla. Por, i menjëhershëm ka qenë reagimi i Spahos, i cili është distancuar plotësisht nga kandidatúra e Bodes, e cila sipas tij, nuk është e PD-së, por e kryeministrit. "Ritvan Bode



Mbledhja e djeshme e Këshillit Bashkiak

Prëzimi i dekretit të Metës për tatimet, opozita: Faqe e zezë, anuloheni

Opozita ka kundërshtuar dje rrëzimin nga mazhoranca të dekretit të Presidentit të Republikës për "Tatimin mbi të ardhurat". Bëhet fjalë për procedurën e ndjekur nga parlamenti, i cili sipas saj e futi atë në votim në kundërshtim të plotë me Rregulloren e Kuvendit. Kryetari i grupit parlamentar të PD, Edmond Spaho tha se Komisioni i Ekonomisë dhe më pas edhe seanca plenare janë mbledhur dhe kanë votuar për rrëzimin e dekretit në shkelje të rregullores. "Ju kujtova që nuk ka ndodhur ndonjëherë që paralelisht me seancën plenare të zhvillohen mbledhje komisioni. Edhe kur janë zhvilluar në seancën e Kuvendit është ndërprerë seanca dhe është zhvilluar me konsensusin e dy palëve. Mbledhja dje nuk ka pasur konsensus. Rruga që keni ndjekur është tërësisht në kundërshtim me rregulloren e Kuvendit", tha Spaho. Edhe kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, tha se Kuvendi është kthyer në kooperativë dhe ka rënë në një batak, ku Rregullorja dhe ligji nuk kanë asnjë vlerë. "Kjo është një faqe e zezë për këtë parlament e për të tërë. Në qoftë se ka ndonjë gram integritet ky parlament, ndërtoni procedurën e anulimit të të gjithë kësaj procedure, të hetohet deri në fund mënyra e veprimit. Në të gjitha këto pikëpamje jemi përpara një skandali, të cilin unë nuk kuptoj dot më", tha Vasili. Ndërkohë, kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi tha se çdo gjë është bërë sipas rregullores dhe se dekreti është futur në rendin e ditës me kërkesë të kreut të grupit të PS. "Neni që flet për dekretin e presidentit, detyron kryetarin e Kuvendit që menjëherë t'ia adresojë komisionit përkatës dhe menjëherë sa ka ardhur e kam adresuar. Ky është sqarimi im. Është e vërtetë që nuk ka qenë në rendin e ditës. Atë herë dje në seancë kryetari i grupit të mazhorancës me kërkesë me shkrim i është drejtuar drejtuesit të seancës për ta vendosur në rend të ditës. Këtë kërkesë e kam lexuar në seancë, ka pasur diskutim dhe e kam hedhur në votim dhe ka marrë 3/5 e votave", tha Ruçi.

nuk është përfaqësues i PD-së, por është i Edi Ramës. Trego një dokument komunikimi që ke bërë me PD-në, ose me pakicën në parlament për këtë çështje", u shpreh Spaho. Ndërkohë që deputeti Oerd Bylykbashi ka pretenduar se jo vetëm për shkak të emrave, por edhe të procedurës së ndjekur nga mazhoranca është tërësisht antikush-

tetuese dhe në kundërshtim me rregulloren. Sipas tij, nuk ka qenë zbatuar asnjëherë praktika që 3 kandidatúra të jenë mbështetur në bllok nga 28 deputetë. "Ju i sillni të tre kandidatët me 28 firma. Ndërkohë që ligji thotë 28 për një kandidat. Në të shkuarën kandidaturat kanë ardhur një kandidat me 28 firma", tha Bylykbashi.



Unaza e Madhe, banorët e "Astirit" dhe Bregut të Lumit protestojnë përpara bashkisë

Veliaj mohon lejen për Begon: Do t'i drejtohem prokurorisë

Bashkia diskuton buxhetin, opozita bojkot

Këshilli Bashkiak i Tiranës diskutoi dje buxhetin 2019 dhe kreditë e buta të dhëna nga bashkia. Këshilltarët bashkiakë të Partisë Demokratike nuk morën pjesë, ndërsa jashtë ambienteve të Bashkisë së Tiranës protestuan banorët të prekur nga projekti "Unaza e Madhe", duke protestuar. Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj e nisi mbledhjen e djeshme të këshillit bashkiak me denoncimin e Partisë Demokratike, ku deputetja Jorida Tabaku dhe këshilltari ligjor Gazmend Bardhi deklaruan se ai së bashku me kryeministrin Edi Rama po e shfrytëzojnë projektin e Unazës së Madhe për t'i hapur rrugë ndërimit të një rezidence luksoze të trafikantit të drogës, Edmond Bego. Veliaj i hodhi poshtë këto akuzat dhe u shpreh se nëse gjendet qoftë edhe një dokument i vetëm që e vërteton diçka të tillë, ai do të japë dorëheqjen nga posti i kryetarit të Bashkisë së Tiranës. Kryebashkiaku përmendi edhe situatën në Qyteti Studenti, duke i cilësuar deputetët demokratë si zaptues të pjesës më të madhe të hapësirave në të. Për arsyet e përmendura, Veliaj bëri të ditur se do t'i drejtohet prokurorisë. Më tej, Veliaj deklaroi se Jorida Tabaku në kohën kur kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha ishte në krye të Bashkisë së Tiranës ka përfutur leje ndërtime. Veliaj përmendi edhe situatën në Qyteti Studenti, duke i cilësuar deputetët demokratë si zaptues të pjesës më të madhe të hapësirave në të. Për arsyet e përmendura, Veliaj bëri të ditur se do t'i drejtohet prokurorisë. "Ata e kanë marrë shprehjen me të vrarë me bukë në gojë shumë seriozisht, thonë që studentët s'kanë për të ngrënë bukë, po si do të hanë studentët kur ato kanë privatizuar të gjitha mensat", u shpreh kryetari i Bashkisë së Tiranës. Po dje këshilltari i Partisë Demokratike në Këshillin Bashkiak të Ti-



Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj

AKUZA Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, dje hodhi poshtë denoncimet e Partisë Demokratike për projektin e Unazës së Madhe, sipas të cilit bashkia i ka dhënë leje ndërtime për një projekt rezidencial, biznesmenit të akuzuar për trafik droge, Edmond Bego. Sipas Veliajt, bashkia nuk ka asnjë leje ndërtime të lëshuar në këtë zonë për Edmond Begon.

SHKURTE

Zgjedhjet, Kokëdhima: Sistemi është marrë peng, do bojkotojmë

Kreu i partisë "Zgjidhja", Koço Kokëdhima, paralajmëroi dje bojkot nga partitë e vogla të zgjedhjeve vendore. Në tryezën e këtyre partive, ai tha se zgjedhjet janë marrë peng nga PD, PS dhe LSI. Për situatën, Kokëdhima fajësoi OSBE-në dhe selitë diplomatike në vendin tonë. Në tryezën e partive të vogla, kreu i "Zgjidhjes", Koço Kokëdhima, bëri thirrje për bojkot të zgjedhjeve vendore të 30 qershorit. "Triada PS+PD+LSI vetëm po retushon Kodin Zgjedhor dhe po përgatit farsën zgjedhore për t'u hedhur hi syve opinionit të brendshëm dhe PE. Dëshirojmë t'i bëjmë të qartë përfaqësuesve të OSBE/ODIHR dhe diplomatëve të vendeve mike në Tiranë se ne nuk pajtohemi me farësen zgjedhore dhe do rishikojmë pjesëmarrjen në zgjedhjet vendore, që nuk kanë shanse të jenë më të mira se zgjedhjet e shkuara", tha z.Kokëdhima. Në tryezë ishin edhe përfaqësues të protestës studenteve, protestës së Unazës së Re dhe asaj të teatrit. Kokëdhima i kërkoi kryeministrin të plotësojë kërkesat e tyre.

Meta ndan dekoratën "Nënë Tereza" për fondacionin "Fundjavë Ndryshe"

Presidenti i Republikës vlerësoi dje me anë një cere moni të veçantë fondacionin bamirës "Fundjavë Ndryshe" me dekoratën "Nënë Tereza". "Në shenjë vlerësimi për kontributin e çmuar dhe të vazhdueshëm në ndihmë të familjeve të varfra, duke përmirësuar ndjeshëm jetesën e tyre. Kjo veprimtari humanitare është kthyer në shembull frymëzimi për të rinjtë dhe ka forcuar solidaritetin e shoqërisë ndaj shtresave në nevojë". Në fjalën e mbajtur në praninë e drejtuesve dhe përkrashëve të bordit themelues të fondacionit, aktivistëve vullnetarë, krerëve e klerikëve të bashkësive të fetare shqiptare, pedagogëve, gazetarëve dhe artistëve të ftuar, Presidenti Meta vuri në dukje se ka kënaqësinë e veçantë që të nderojë me dekoratën e lartë "Nënë Tereza", fondacionin "Fundjavë Ndryshe", një fondacion që mbledh brenda vetes një numër të madh të rinjsh e të rejash shumë aktivë, veçanërisht në fushën sociale.

Ripërpilojnë kërkesat dhe ia dorëzojnë Kuvendit

Mbyllet protesta e studentëve: Do të rikthehem më të fortë në janar

Pas 17 ditëve rezistencë, studentët mbyllën dje protestën e tyre për t'u rikthyer sërish në janar me kauzën për plotësimin e 8 pikave. Studentët thanë se protesta e tyre do të rikthehet edhe më të fortë vitin e ardhshëm. "Të gjitha fakultetet kanë marrë një vendim që sot të jetë dita e fundit e protestës për këtë vit dhe do të rikthehem përsëri në janar me të gjithë fuqinë dhe me qëndresën tonë të palëkundur ndaj kauzës sonë". Studentët kanë riformuluar tetë kërkesat e tyre dhe i kanë dorëzuar dje në Kuvend, i cili zhvilloi 7 orë diskutime për kërkesën e opozitës për vettingun e politikanëve. Studentët dolën fillimisht me 4 kushte, që lidheshin me heqjen e tarifave për provimet e parapambetura, pjesëmarrja në bor-



AMBASADORI I BULLGARISË "Propozoj një dialog të zgjuar midis njerëzve të urtë dhe jam i bindur që kjo do të ndodhë. Do gjejmë një gjuhë të përbashkët, të ulen të diskutojmë mbi problemet që kanë dalë. Të gjejmë mundësitë për t'i zgjidhur ato, të gjejmë një mënyrë për ta realizuar në afate sa më të shkurtra, që karakteristike për vendet e zhvilluara është dialogu", tha z.Raytchevski.

de, vota e studentit si edhe përmirësimi i kushteve në konvikte. Ambasadori bullgar Momchil Stoyanov Raytchevski apeloji dhe për dialog mes studentëve dhe qeverisë. Gjatë një vizite në Korçë, ai u shpreh i bindur për gjetjen e zgjidhjes: "Unë si ambasador dhe përfaqësues i Bullgarisë në shtetet europiane propozoj një dialog të zgjuar midis

njerëzve të urtë dhe jam i bindur që kjo do të ndodhë. Do gjejmë një gjuhë të përbashkët, të ulen të diskutojmë mbi problemet që kanë dalë, të gjejmë mundësitë për t'i zgjidhur ato, të gjejmë një mënyrë për ta realizuar në afate sa më të shkurtra. Karakteristikë për vendet e zhvilluara është dialogu".

ranës, Fabian Topollaj, bëri publik vendimin e tij për të dorëzuar mandatin e marrë me votën e qytetarëve të Tiranës. "Jam duke dorëzuar një mandat, i cili vetëm atyre që më kanë zgjedhur nuk u shërben", shkruan ai në

një shënim në rrjetin social "Facebook". "Ky mandat gjithashtu nuk ka më asnjë vlerë po të kemi parasysh se individualisht kam nisur 4 procese gjyqësore për anulimin e vendimeve haptazi antiligjore të

këshillit bashkiak nën diktatin e Veliajt dhe gjykata ose ka shkelur me të dyja këmbët ligjin, ose zvarrit çështjet vetëm sepse nuk guxon të shpallë një vendim kundër Veliajt", shkruan Topollaj.

NJOFTIM ANKANDI

1. Shoqëria e Përmbarrimit "BALIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k njofton Shpalljen e Ankandit të II (dytë), për shitjen e pasurisë ULLISHTË , me sip.3,400 m², Zona Kadastrale: 1615 Numri i Pasurisë: 327/1, Vol. 1, Faqe 221, ndodhur në Fier-Shegan Lushnje, në pronësi të: z. Bajram Seferi Strazi , i datëlindjes 14.11.1967. Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në vlerën **1,804,000 (një milion e nëntëqind e katër mijë) LEKË**.

Ankandi do të zhvillohet më datë **16.01.2019, ora 16:00**, pranë zyrës së Shoqërisë së Përmbarrimit "BALIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k, në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telefon 042320227, email: gbyrth@hotmail.com.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARRIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

PASURIA nr. 1/355, e lloji "Trruall dhe Ndërtesë" (godinë banimi dhe shërbime 3 kate e ndodhur në Ish-Fushën e Avianicori) me sipërfaqe të truallit 273 m² dhe sipërfaqe ndërtime prej 200.2 m², Zona Kadastrale 8220, Vol. 23, Fq. 28, e regjistruar në Regjistrin Hipotekeq Nr. 18, datë 07.01.2011 pranë Z.V.R.PP TIRANË, në pronësi të Znj. DENKË SEFERI.

ÇMIMI **36.389.985,28 LEKË**. Data e zhvillimit të ankandit do jetë **03.01.2018**.

CEL. 0684026566 ; 0693262866 .

DOMINUS Njoftim Shitje ne Ankand

Shoqëria Përmbarrimore "Dominus" Rruga "Sami frasheri"pili "Titani", kati trete Tirane. cel 0692051522

Shitje ne ankand e d yte te pasurise: Tokë Arë, Nr.Pasurie 104/16, ZK 3774, vol 3, faqe 141, e ndodhur në Vllë-Ballaj, Kavajë

Çmimi me të cilin fillon shitja e pasurisë në ankandin e d yte është 1.323.000 lekë (një milion e treqind e njëzet e tre mijë)

Ankandi do të zhvillohet ne daten 25.12.2018, ora 16.00.

Kërkesa të veçanta, buxhetit i kursethet në total një fond në vlerën 215 milionë lekë

Kompensimi i pronave, ndahen 138 milionë

Drejtoresha e ATP: Përfituan 13 familje, ja si do të ndahen

Agjencia e Trajimit të Pronave (ATP) njofton se më datë 21.12.2018 ka përfunduar procesin e shqyrtimit administrativ të disa aplikimeve për kompensim financiar me kërkesë të veçantë, të paraqitura nga subjektet e interesuara, të cilat disponojnë vendime përfundimtare që u kanë njohur të drejtën e kompensimit të pronës. Aktualisht ka përfunduar shqyrtimi administrativ i 13 (trembëdhjetë) aplikimeve për kompensim financiar me kërkesë të veçantë. Fondi financiar i vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, që ATP do të shpërndajë në total për subjektet përfituese të këtyre 13 (trembëdhjetë) aplikimeve sipas kërkesave të tyre është në vlerën 138'581'673,88 (njëqind e tridhjetë e tetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre presje të tetëdhjetë e tetë) lekë, nga të cilat 29'999'437,90 (njëzet e nëntë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një mijë e



Foto ilustruese

katërqind e tridhjetë e shtatë presje nëntëdhjetë) lekë do të lëvrohen menjëherë, ndërsa pjesa tjetër do të lëvrohet me këste çdo fillim viti buxhetor, bazuar në mënyrën e përfitim të kompensimit për të cilën ka aplikuar subjekti. "Nga përfundimi i trajtimit të këtyre

13 aplikimeve për kompensim financiar, Buxheti të Shtetit i kursethet në total një fond në vlerën 215'928'031,82 (dyqind e pesëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e njëzet e tetë mijë e tridhjetë e një presje të tetëdhjetë e dy) lekë", tha drejtoresha e ATP, Jonida Baçi.

NR.	VENDIMI I KKKP				QARKU	SUBJEKTI SHPRONËSUAR		PËRFAQËSUESI ME PROKURË		APLIKIMI NË ATP		KËRKESA E SUBJEKTI PËR KOMPENSIM TË VEÇANTË
	NR.	DATE	MUJ	VITI		EMËR	MBIEMËR	EMËR	MBIEMËR	MILIONE	DITË HAPËSË PËS	
1	2	12	4	1995	BËRAT	LAVER	LAMÇE	SEFEDIN	LAMÇE	950	27.07.2017	20%
2	198	7	8	1998	DURRES	ZENEL	PREZA	HAVA	GODINA	43	06.02.2018	20%
3	42	27	5	1997	TIRANE	MEHMET	BYLYKBASHI	MEHMET	BYLYKBASHI	1276	05.12.2018	30%
4	775	13	10	1994	TIRANE	RENHAI	KOSTURI	SOKOL	SHALA	904	18.07.2017	40%
5	590	11	3	1995	DURRES	ANASTAS	ARALLAMBI	ANASTAS	ARALLAMBI	1270	03.12.2018	40%
6	140	26	6	1995	TIRANE	BAJRAM	TOSKA	FATMIRA	TOSKA	750	20.06.2017	40%
7	422	9	10	1995	TIRANE	ISUF	BERNOLLI	BRUNILDA	SHIROKA	1250	23.10.2017	40%
8	858	16	10	1995	SHKODER	SADETIN	BILALI	FITNET	BILALI	1044	04.09.2018	40%
9	327	16	11	1995	TIRANE	MBHAL	MARTO	ATNAN	SIMIXHI	452	16.05.2017	40%
10	351	6	12	1995	TIRANE	NDOC	KOLIQI	MIRIAM	PEÇI	1112	15.09.2017	40%
11	376	19	12	1995	TIRANE	BEHXHET	FRASHERI	ROZETA	PLASARI	530	25.05.2017	40%
12	1148	2	7	1996	SHKODER	MUSA	KRAJA	AGIM	KRAJA	1152	17.10.2018	40%
13	12	15	4	1997	TIRANE	SHEFIK	POJANI	FATMIRE	POJANI	1221	13.11.2018	40%

REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST (CONSULTING SERVICES - INDIVIDUAL SELECTION)

Second Multi-Donor Trust Fund for Capacity Building Support to the Implementation of the Integrated Planning System (IPS 2)
Consulting Service
For
Local Consultant
Communications Specialists to support Public Relations and Change Management activities

ALBANIA

Project: Second Multi-Donor Trust Fund for Capacity Building Support to the Implementation of the Integrated Planning System (IPS 2)

Project ID: P125332

Assignment Title: Communications Specialists to support Public Relations and Change Management activities

Ref. No: AL-IPS2-P125332-IC-CS-18-04-07

The Government of Albania has received financing from the World Bank toward the cost of the Second Multi-Donor Trust Fund for Capacity Building Support to the Implementation of the Integrated Planning System (IPS 2) Project.

The IPS 2 Project will support the Government of Albania in further strengthening the implementation of the Integrated Planning System (IPS), which links strategic policy planning with the budget planning and public financial management more broadly. Main beneficiaries of this project are the Ministry of Finance and Economy (MoFE), the Department for Development and Good Governance (DDGG), and the Department of Public Administration (DoPA) under the Prime Minister Office (PMO).

Due to the involvement of several key stakeholders and execution of a number of activities in parallel, there is a need for effective awareness and communication of IPS 2 ongoing activities, organization of joint events to share the developments and progress, develop a communication campaign to closely monitor and promote the achievements of project implementation. Additionally, the AFMIS, EAMIS and PISIS project teams developed their change management plans, and a comprehensive communications strategy and action plan should be prepared and implemented to support these activities.

To support the change management and public relations for ongoing project activities, the MoFE will hire a local communications expert (further on referred to as the Consultant).

The main objective of this assignment is to assist the MoFE for the preparation, and implementation of an effective communication strategy, action plan and campaign related to integrated programmes and project activities and their impact on the life of Albanian citizens, as well as the public employees and government entities.

The Central Finance and Contracting Unit nearby the Ministry of Finance of Albania invites eligible Consultants to indicate their interest in providing the Services.

Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services. The qualifications required are:

- University degree in one of the relevant disciplines: journalism, public or international relations, marketing, communications, social sciences, or similar. (Master degree in one of these fields will be considered as an advantage)
- Not less than 3 years of practical experience in developing Communication Strategy/Action Plans/ Public Relations Campaigns/ Social Media products, or involved in communication/media projects related to public sector and/or private sector.
- Proven track record of providing effective communication and PR support to government entities for similar activities will be considered as an advantage.
- Excellent communication, monitoring, analytical and report writing skills.
- Working experience with EU and/or other Donors agencies is desirable.
- Fluency in both Albanian and English languages is required.

565	Brunilda Nosi	Peqini	2+1	7130960	665	Rijana Veli	Keçi	2+1	7130960	765	Emiljano Neim	Lame	2+1	7130960
566	Arjan Neshet	Pajo	1+1	5348220	666	Shkëlqim Avni	Çollaku	2+1	7130960	766	Luljeta Neki	Cela	2+1	7130960
567	Halit Demir	Dusha	1+1	5348220	667	Erjon Agim	Kënga	1+1	5348220	767	Klajdi Ndrëçim	Duka	2+1	7130960
568	Mimoza Rifat	Çoku	1+1	5348220	668	Elida Muhamet	Malocali	2+1	7130960	768	Marvin Agim	Zyberli	2+1	7130960
569	Ylber Nezir	Shahini	2+1	7130960	669	Zhaneta Hamza	Shutina	2+1	7130960	769	Brikena Përparim	Muçaj	2+1	7130960
570	Arben Gani	Koçiu	1+1	5348220	670	Elton Zeni	Jaupi	2+1	7130960	770	Besmir Fatmir	Agalliu	2+1	7130960
571	Markelian Ymerli	Hoxha	1+1	5348220	671	Glesilda Gjergji	Limka	1+1	5348220	771	Artur Sami	Guzina	2+1	7130960
572	Shkëlqim Sherif	Tila	1+1	5348220	672	Migena Qamil	Avdia	1+1	5348220	772	Artan Bashkim	Duva	2+1	7130960
573	Ilir Gani	Xhaka	1+1	5348220	673	Ergys Vasil	Dako	1+1	5348220	773	Aurora Agron	Isallari	1+1	5348220
574	Romeo Lefter	Çiçolli	2+1	7130960	674	Rudina Ibrahim	Sejdini	1+1	5348220	774	Ramadan Selam	Ajasllari	1+1	5348220
575	Fatbardha Bajram	Osmani	2+1	7130960	675	Teuta Isa	Guri	1+1	5348220	775	Hair Beqir	Beqo	2+1	7130960
576	Petrit Shkurt	Çullhaj	1+1	5348220	676	Arjola Xhevit	Nurja	1+1	5348220	776	Sestavi Llazar	Diamanti	2+1	7130960
577	Rexhep Myslim	Muja	2+1	7130960	677	Manjola Spiro	Kristo	1+1	5348220	777	Ermelinda Albert	velo	1+1	5348220
578	Lorin Lulezim	Juniku	1+1	5348220	678	Bardha Shefqet	Mara	1+1	5348220	778	Aurora Rafail	Bushi	1+1	5348220
579	Andi Lavdimir	Bejo	2+1	7130960	679	Anisa Ferit	Caka	1+1	5348220	779	Eduard Mirash	Mrishaj	1+1	5348220
580	Orald Skënder	Karapici	2+1	7130960	680	Eliana Sabri	Mukaj	1+1	5348220	780	Nertila Ridvan	Mulla	1+1	5348220
581	Redona Dashnor	Shehaj	2+1	7130960	681	Juliana Merqez	Gaxha	1+1	5348220	781	Antiola Andon	Zotaj	1+1	5348220
582	Denajda Fatlli	Xhafaeraj	2+1	7130960	682	Alba Arben	Zhori	1+1	5348220	782	Joana Afrim	Mullara	2+1	7130960
583	Arjana Besim	Çoço	1+1	5348220	683	Nentorjada Ferdi	Kasëmi	1+1	5348220	783	Jurgen Petrit	Mulla	2+1	7130960
584	Edvina Lutfi	Kallesi	1+1	5348220	684	Oliana Rajmondi	Gjergjeji	1+1	5348220	784	Kledion Nevruz	Çullaj	1+1	5348220
585	Artur Xhezo	Dollani	1+1	5348220	685									

796	Faik	Ali	Bitri	1+1	5348220	898	Elda	Shefqet	Ahmetaj	Gasionere4456850	1000	Kolin	Vlash	Laska	Gasionere4456850		
797	Xhevahire	Selim	Sinani	2+1	7130960	899	Jonida	Novruz	Halili	Gasionere4456850	1001	Esmiralda	Gëzim	Gorovelli	Gasionere	4456850	
798	Klodiana	Haki	Danaj		Gasionere4456850	900	Erlis	Fatmir	Celo	Gasionere4456850	1002	Nertil	Petrit	Dushko	Gasionere	4456850	
799	Senada	Spart	Jaho		Gasionere4456850	901	Milena	Alfred	Memsuri	Gasionere4456850	1003	Ritano	Artur	Nano	Gasionere	4456850	
800	Erleda	Gaqi	Xharo		Gasionere4456850	902	Romina	Vullnetar	Braimllari	Gasionere4456850	1004	Suada	Zehad	Hawa	Gasionere	4456850	
801	Miranda	Mehmet	Goçi		Gasionere4456850	903	Eralda	Bardhyl	Çela	Gasionere4456850	1005	Besnik	Kirovë	Rugji	Gasionere	4456850	
802	Enkelana	Bashkim	Shala		Gasionere4456850	904	Flutura	Bashkim	Lamçe	Gasionere4456850	1006	Ardita	Xhevat	Nerguti	Gasionere	4456850	
803	Marsela	Vladimir	Çibukaj		Gasionere4456850	905	Elton	Guri	Maçolli	Gasionere4456850	1007	Mirela	Gëzim	Zaçe	Gasionere	4456850	
804	Zegjine	Faredin	Kurti		Gasionere4456850	906	Florina	Zenel	Hajredinaj	Gasionere4456850	1008	Denardo	Gëzim	Sinanaj	Gasionere	4456850	
805	Alma	Përparim	Tola		Gasionere4456850	907	Migena	Ahmet	Cina	Gasionere4456850	1009	Jorxhilda	PandiNani		Gasionere	4456850	
806	Erlin	Qatip	Myrtaj		Gasionere4456850	908	Oltjana	Rexhep	Penxha	Gasionere4456850	1010	Anila	Dhimitër	Panajoti	Gasionere	4456850	
807	Mariglen	Agron	Mushgjata		Gasionere4456850	909	Elsa	Tare	Kantollari	Gasionere4456850	1011	Besmira	Bexhet	Nuredini	Gasionere	4456850	
808	Granit	Dalip	Sulko		Gasionere4456850	910	Dorina	Thoma	Prifti	Gasionere4456850	1012	Elisabeta	Jorgji	Çarçui	Gasionere	4456850	
809	Petrit	Shpëtim	Berati		Gasionere4456850	911	Stela	Thoma	Sidhri	Gasionere4456850	1013	Aurora	Hajdar	Cekani	Gasionere	4456850	
810	Florida	Avni	Vasjari		Gasionere4456850	912	Eneida	Aleks	Çobani	Gasionere4456850	1014	Janisa	Agim	Habibi	Gasionere	4456850	
811	Xheni	Bashkim	Tresa		Gasionere4456850	913	Ergi	Gëzim	Mustafaj	Gasionere4456850	1015	Angjelo	Kujtim	Mezini	Gasionere	4456850	
812	Bledjan	Haxhi	Neli		Gasionere4456850	914	Blerina	Agim	Idrizi	Gasionere4456850	1016	Adela	Vladimir	Kila	Gasionere	4456850	
813	Elsava	Sali	Dedja		Gasionere4456850	915	Artur	Enver	Braçaj	Gasionere4456850	1017	Irma	Kiu	Paloli	Gasionere	4456850	
814	Ana	Zija	Shkreta		Gasionere4456850	916	Artur	Islam	Banaj	Gasionere4456850	1018	Martin	Petrit	Beqiraj	Gasionere	4456850	
815	Sokol	Myslym	Shajta		Gasionere4456850	917	Erlisa	Durim	Shena	Gasionere4456850	1019	Genti	Agron	Haderaj	Gasionere	4456850	
816	Amarilda	Arshin	Braho		Gasionere4456850	918	Albi	Jahja	Halilaj	Gasionere4456850	1020	Arbër	Fatos	Bedaj	Gasionere	4456850	
817	Iva	Esat	Balla		Gasionere4456850	919	Adela	Bari	Cenga	Gasionere4456850	1021	Erion	Servet	Azizolli	Gasionere	4456850	
818	Dorina	Bujar	Begolli		Gasionere4456850	920	Sonila	Qemal	Mema	Gasionere4456850	1022	Kreshnik	Rrahman	Hallaçi	Gasionere	4456850	
819	Ornel	piro	Tola		Gasionere4456850	921	Renato	Kujtim	Elezi	Gasionere4456850	1023	Elna	Hasan	Mulçeci	Gasionere	4456850	
820	Brikena	Gjon	Çoku		Gasionere4456850	922	Emro	Lufti	Hoxhaj	Gasionere4456850	1024	Aurel	Ajet	Celibashi	Gasionere	4456850	
821	Edlira	Xhemal	Midha		Gasionere4456850	923	Rena	Memo	Hasani	Gasionere4456850	1025	Lirela	Kastriot	Çiçi	Gasionere	4456850	
822	Erjon	Rrahim	Alliu		Gasionere4456850	924	Igll	Stavri	Binjaku	Gasionere4456850	1026	Vjonis	Nikoll	Dedja	Gasionere	4456850	
823	Eralda	Perparim	Hoxha		Gasionere4456850	925	Entela	Enver	Duraj	Gasionere4456850	1027	Megi	Bujar	Hodo	Gasionere	4456850	
824	Eriona	Agim	Goxha		Gasionere4456850	926	Edmond	Qetsor	Faqeçkuqi	Gasionere4456850	1028	Zamir	Fatmir	Palushi	Gasionere	4456850	
825	Enkeleida	Zenjel	Fejzo		Gasionere4456850	927	Salarjona	Mexhit	Ruka	Gasionere4456850	1029	Nensi	Vasil	Mitre	Gasionere	4456850	
826	Desara	Vladimir	Qose		Gasionere4456850	928	Enid	Vladimir	Xherahu	Gasionere4456850	1030	Amaraldo	Gribos	Liçaj	Gasionere	4456850	
827	Ardit	Sazan	Miraçi		Gasionere4456850	929	Feliks	Asqeri	Hoda	Gasionere4456850	1031	Silver	Bep	Gargjola	Gasionere	4456850	
828	Anila	Bexhet	Dukaj		Gasionere4456850	930	Armand	Avzi	Hoxha	Gasionere4456850	1032	Dorian	Ramadan	Shehu	Gasionere	4456850	
829	Todi	Noikollaç	Karoli		Gasionere4456850	931	Sara	Sefedin	Juniku	Gasionere4456850	1033	Bruno	Petraç	Puli	1+1	5348220	
830	Abedin	Bukurosh	Uka		Gasionere4456850	932	Marsida	Bujar	Hajdini	Gasionere4456850	1034	Albert	Veledin	Merdanaj	Gasionere	4456850	
831	Ulpiana	Flamur	Aliaj		Gasionere4456850	933	Fation	Astrit	Goxhaj	Gasionere4456850	1035	Areta	Virjon	Hysaj	Gasionere	4456850	
832	Ezoarta	Gjergj	Vasijaj		Gasionere4456850	934	Erlin	Xhevat	Luli	Gasionere4456850	1036	Devis	Bujar	Kokoli	1+1	5348220	
833	Florenc	Kujtim	Çekrezi		Gasionere4456850	935	Solita	Ylli	Xhanaj	Gasionere4456850	1037	Krenar	Zenel	Guçe	Gasionere	4456850	
834	Entela	Vangjel	Shano		Gasionere4456850	936	Çentjan	Fari	Deshati	Gasionere4456850	1038	Liridon	Petrit	Çala	1+1	5348220	
835	Altjon	Virjon	Lacaj		Gasionere4456850	937	Enkeleud	Kujtim	Limani	Gasionere4456850	1039	Laert	Illa	Vasili	Gasionere	4456850	
836	Enea	Agim	Kusaraj		Gasionere4456850	938	Xhensila	Saimir	Mullaj	Gasionere4456850	1040	Luljeta	Rako	Bitri	Gasionere	4456850	
837	Marin	Abdulla	Çeça		Gasionere4456850	939	Dake	Prenç	Perdedaj	Gasionere4456850	1041	Arjan	Jonus	Hodo	Gasionere	4456850	
838	Amanda	Gjergji	Bellovoda		Gasionere4456850	940	Eugert	Braho	Isaraj	Gasionere4456850	1042	Blerita	Bujar	Çekiçi	Gasionere	4456850	
839	Matilda	Sulaj	Hidri		Gasionere4456850	941	Blerina	Kristaq	Ngjela	Gasionere4456850	1043	Fjoralba	Fatmir	Jahupi	Gasionere	4456850	
840	Harrjan	Edmond	Lila		Gasionere4456850	942	Megi	Maria	Qirjako	Gasionere4456850	1044	Amarildo	Refik	Ymeri	Gasionere	4456850	
841	Xhovan	Mihal	Kote		Gasionere4456850	943	Alda	Dashamir	Seljo	Gasionere4456850	1045	Alba	Alfred	Jani	Gasionere	4456850	
842	Viilma	Qemal	Dashja		Gasionere4456850	944	Hajdi	Arian	Gorica	Gasionere4456850	1046	Endri	Vait	Musta	Gasionere	4456850	
843	Doned	Fatmir	Hënjaj		Gasionere4456850	945	Elvira	Gjergji	Stoja	Gasionere4456850	1047	Mia	Valter	Koka	Gasionere	4456850	
844	Ardita	Periz	Avdiçaj		Gasionere4456850	946	Erion	Gogo	Gjivogli	Gasionere4456850	1048	Manuela	Shkëlqim	Çuko	Gasionere	4456850	
845	Eliana	Qemal	Tara		Gasionere4456850	947	Albana	Vangjel	Kërthi	Gasionere4456850	1049	Lorenc	Bardhyl	Golemi	Gasionere	4456850	
846	Halil	Ditar	Hodaj		Gasionere4456850	948	Jorida	Aleksander	Permeti	Gasionere4456850	1050	Bruno	Sako	Koçi	Gasionere	4456850	
847	Denisa	Thoma	Mihali		Gasionere4456850	949	Milonja	Sejdi	Sejditi	Gasionere4456850	1051	Maribel	Kolec	Frruko	Gasionere	4456850	
848	Armand	Iljas	Dervishi		Gasionere4456850	950	Zamira	Xhaferr	Hoxha	Gasionere4456850	1052	Silvana	Asllan	Brylyku	Gasionere	4456850	
849	Suela	Skënder	Rrapaj		Gasionere4456850	951	Ergys	Lazer	Hila	Gasionere4456850	1053	Desantila	Mersin	Muja	Gasionere	4456850	
850	Zamira	Caf	Kodra		Gasionere4456850	952	Arlin	Arben	Morina	Gasionere4456850	1054	Gëzim	Rasim	Shehu	Gasionere	4456850	
851	Klaudiana	Foto	Soko		Gasionere4456850	953	Eni	Jorgo	Morava	Gasionere4456850	1055	Blerina	Xhemal	Kazaferi	Gasionere	4456850	
852	Olti	Petrit	Nakaj		Gasionere4456850	954	Elson	Gjon	Lleshi	Gasionere4456850	1056	Elda	Rexhep	Çuka	Gasionere	4456850	
853	Viola	Shefqet	Softa		Gasionere4456850	955	Denisa	Namik	Brahimllari	Gasionere4456850	1057	Renaldo	Kthim	Gaçe	Gasionere	4456850	
854	Elvira	Pullumb	Skenduli		Gasionere4456850	956	Egra	Astrit	Ibrahimi	Gasionere4456850	1058	Dorjan	Thanas	Zhaka	Gasionere	4456850	
855	Trendelina	Qerim	Hasanaj		Gasionere4456850	957	Ejona	Ligor	Shkurti	Gasionere4456850	1059	Elisa	Nazmi	Çela	Gasionere	4456850	
856	Bledar	Ymer	Xhizdari		Gasionere4456850	958	Aida	Hamid	Baro	Gasionere4456850	1060	Anisa	Pavli	Dhimitri	Gasionere	4456850	
857	Suldan	Luan	Barjamaj		Gasionere4456850	959	Elton	Islam	Karaj	1+1	5348220	1061	Klodian	Agim	Shevroja	Gasionere	4456850
858	Kevin	Sherif	Kopani		Gasionere4456850	960	Arjola	Xhevat	Lata	Gasionere4456850	1062	Artida	Grazoç	Hysenaj	1+1	5348220	
859	Besmira	Hektor	Hoxhaj		Gasionere4456850	961	Erion	Stavri	Dushi	Gasionere4456850	1063	Edona	Fahri	Kraja	Gasionere	4456850	
860	Blerita	Mitat	Cake		Gasionere4456850	962	Bledar	Bashkim	Thomaj	Gasionere4456850	1064	Alma	Halit	Piro	Gasionere	4456850	
861	Vait	Hariz	Koshi		Gasionere4456850	963	Gurali	Nezir	Hana	Gasionere4456850	1065	Alda	Besnik	Qira	Gasionere	4456850	
862	Neritan	Vangjel	Gjergjo		Gasionere4456850	964	Rajmonda	Qamil	Yryku	Gasionere4456850	1066	Gjergji	Hisen	Tola	Gasionere	4456850	
863	Donald	Festim	Bajrami		Gasionere4456850	965	Xhoana	Bashkim	Caka	Gasionere4456850	1067	Markejlana	Astrit	Hamzallari	Gasionere	4456850	
864	Rezarta	Safet	Brahimi		Gasionere4456850	966	Enkeleud	Anastas	Vidhi	Gasionere4456850	1068	Ernelinda	Fadil	Shkurti	1+1	5348220	
865	Avushe	Sadik	Zhuka		Gasionere4456850	967	Bledi	Qebir	Isaraj	Gasionere4456850	1069	Andi	Fari	Deshati	Gasionere	4456850	
866	Gert	Josif	Dajko		Gasionere4456850	968	Enkelejdr	Avdyll	Braho	Gasionere4456850	1070	Enxhi	Ali	Koni	Gasionere	4456850	
867	Kliton	Zamir	Sulejmani		Gasionere4456850	969	Anxhelo	Ilir	Çepele	Gasionere4456850	1071	Klaudiu	Edmond	Peqini	1+1	5348220	
868	Shahin	Shuaip	Duka		Gasionere4456850	970	Aldha	Flamur	Bushaj	Gasionere4456850	1072	Ledia	Kujtim	Sulaj	1+1	5348220	
869	Jetmir	Gani	Kallollari		Gasionere4456850	971	Rovena	Shaban	Bixi	Gasionere4456850	1073	Artela	Veli	Gojka	Gasionere	4456850	
870	Oltjon	Hilmi	Balliu		Gasionere4456850	972	Albi	Ramazan	Beka	Gasionere4456850	1074	Ina	Agim	Toro	Gasionere	4456850	
871	Dorjan	Xhevdet	Doka		Gasionere4456850	973	Aldo	Edmond	Hysaj	Gasionere4456850	1075	Denisa	Vladimir	Ymeraj	Gasionere	4456850	
872	Klejdi	Shpëtim	Guga		Gasionere4456850	974	Dorina	Nesim	Kurti	Gasionere4456850	1076	Eranda	Mondi	Likaj	Gasionere	4456850	
873	Erjona	Bajram	Balliu		Gasionere4456850	975	Vojsava	Simo	Konomi	Gasionere4456850	1077	Griselda	Vait	Musta	Gasionere	4456850	
874	Radiana	Xhaferr	Kalemi		Gasionere4456850	976	Sefer	Pëllumb	Loçka	Gasionere4456850	1078	Elisian	Nevrus	Bici	Gasionere	4456850	
875	Dhimitrulla	Petro	Jorgo		Gasionere4456850	977	Fation	Ferik	Zane	Gasionere4456850	1079	Matilda	Dashamir	Idrizaj	Gasionere	4456850	
876	Devis	Hekuran	Veliu		Gasionere4456850	978	Besmir	Ndriçim	Hysa	Gasionere4456850	1080	Lenada	Namik	Muho	Gasionere	4456850	
877	Erjeta	Xheladin	Koçi		Gasionere4456850	979	Armir	Frok	Doda	Gasionere4456850	1081	Enjeda	Gëzim	Zere	Gasionere	4456850	
878	Erjona	Isa	Pemaj		Gasionere4456850	980	Xhijola	Valter	Alinç	1+1	5348220	1082	Jetmir	Valier	Lubonja	Gasionere	4456850
879	Arsen	Astrit	Shehi		Gasionere4456850	981	Elio	Mevlan	Aliçaj	Gasionere4456850	1083	Lediona	dashamir	Kamberi	Gasionere	4456850	
880	Imro	Fatmir	Nazari		Gasionere4456850	982	Elisa										

BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 640

SUPLEMENT I PERJAVSHEM

GAZE TA SHOIPTARE

Redaktore: Pmela Aliaj - Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 22 Dhjetor 2018

SOT FINALJA E 'FEST 57'

kush 'rrëmben' mikrofonin për në "Eurovizion"



Nga këngëtarët ndër vite te fituesit e vjetër, ja surprizat që rezervon nata e tretë. Organizatorja Inva Mula shpreh idenë e zgjedhjes së finalistëve

FOTOT

Insta-Mania, bebat e vip-ave në rrjetet sociale



UNIKE

BËHET BABA PËR HERË TË PARË, JA EMRI I VAJZËS SË MODERATORIT SHQIPTAR



Nga djali i Adelina Tahirit te vajza e Mozzik, ja fëmijët që kanë faqe në 'Instagram' me mijëra ndjekës

Insta-Mania, edhe bebat e vip-ave në rrjetet sociale



Mirëserdhët në botën e reklamimit, minorenet që menaxhohen nga prindërit

Pamela Aliaj

Ditët e sotme rrjetet sociale janë bërë dashur pa dashur një pjesë e përditshmërisë sonë. Shumë prej nesh, përfshirë këtu dhe njerëzit e njohur, i shfrytëzojnë ato sa më shumë duke nxjerrë dhe përfitimë prej tyre ekonomike nga postimet e fotove apo videove si dhe të bashkëpunimeve që bëjnë me firma të ndryshme për të reklamuar një produkt apo shërbim të caktuar kundrejt një pagese. Një gjë e tillë vihet re rëndom tek VIP-at tanë, por, ajo që ne nuk arrijmë të kuptojmë është edhe përfshirja e të porsalinururve apo të fëmijëve minorenet të këtyre personazheve VIP në rrjetet sociale. Nuk janë të paktë ata që kanë vendosur t'u hapin atyre, duke qenë se vetë nuk ia kanë idenë më të vogël se për çfarë bëhet fjalë, të një faqeje në 'Instagram'. Më poshtë po listojmë disa prej tyre, të cilët kanë preferuar t'i bëjnë publikë vogëlushët që në moshë të mitur nëpër rrjetet sociale.

ADELINA TAHIRI ME DJALIN JON

Adelina Tahiri ka vendosur të dalë hapur bashkë me të birin Jon. Deri para pak javëve këngëtarja e njohur përpiquej ta fshihte fytyrën e djalit të saj, por ky vendim ka ndryshuar. Pasi realizoi një set shumë special me të për festat e fundvitit, Adelina ka vendosur që të hapë edhe një profil në 'Instagram' me emrin e djalit. Disa nga fotot e të voglit Jon tashmë janë publikuar. Fëmija i parë për këngëtarën dhe bashkëshortin e saj Serjoza Markov erdhi në jetë rreth dy muaj më herët. Tashmë të gjithë do të mundën ta shohin Jonin teksa rritet çdo ditë. Jon numëron 16.2 mijë ndjekës dhe vetëm 10 postime deri tani.



MAJLINDA ZEKA ME DJALIN ROAN

Dikur Majk dhe ish e dashura e tij Majlinda kishin një histori të bukur dashurie, aq të bukur sa nga kjo dashuri lindi edhe një djalë bukurorsh i cili quhet Roan. Vogëlushi jeton vetëm me të ëmën e tij, e cila i publikon shpesh vogëlushit foto e video të ndryshme në profilin e saj në Instagram. Mirëpo së fundmi Majlinda ka vendosur që Roan të ketë llogarinë e tij personale, të cilën e mendaxhon ajo. Por ajo që i ka habitur të gjithë është veprimi i reperit Majk ndaj të birit. Siç e shohim, megjithëse djali i tij ka një llogari në Instagram, Majk ka vendosur të mos e ndjekë vogëlushin. Roan numëron 12.2 mijë ndjekës dhe vetëm 69 postime.

ÇILJETA XHILAGA ME DJALIN FERNANDO

Çili ka qenë ndër të parat që i ka hapur faqe personale vogëlushit të saj Fernando, që atëherë kur ai ishte i vogël, por tashmë edhe pse kanë kaluar vitet e ne nuk shohim më atë buçkon e vogël nëpër foto, por një vogëlush shumë tërheqës. Edhe pse nuk ka shumë postime, djali i këngëtares ka shumë ndjekës në rrjetin e tij në 'Instagram'. Fernando numëron 11.4 mijë ndjekës dhe vetëm 35 postime.

LOREDANA ZEFI DHE MOZZIK ME VAJZËN HANA

Mozzik e Loredana reklamojnë vajzën në Instagram. Ata vendosin t'i hapin llogari edhe pse ajo s'ka dy ditë që ka lindur. Vajza dyditëshe e çifit tashmë është me shumë ndjekës. Derisa shumë të famshëm zgjedhin të ruajnë identitetin e fëmijëve të tyre dhe të mos e bëjnë publik për fansa, ky nuk është rasti me Mozzik dhe Loredanën. Vajza e tyre, Hana, tashmë ka një llogari personale në Instagram që vazhdimisht po fiton ndjekës, e që tashmë i ka mbi 166 mijë dhe vetëm 2 postime.


Na befason Alban Skënderaj: Ky është koncerti im i fundit!

Alban Skënderaj është një ndër artistët më dashur shqiptar që mbledh me mijëra fansa në çdo koncert që jep, kudo në vend. Por krejt papritur ai ka vendosur të shkëputet nga koncertet dhe performancat e tij pasi vetëm pak më parë ka njoftuar se të shtunën ai do të mbajë koncertin e tij të fundit në Tiranë, ndonëse nuk ka dhënë arsye për këtë shkëputje! "Kjo do të jetë performanca ime e fundit në Tiranë për një kohë të gjatë", shkruan këngëtari. Ende nuk dihet nëse ky largim nga koncertet lidhet me ndonjë pauzë që Albani ka vendosur të marrë për të krijuar apo thjesht për të qëndruar me familjen e tij, bashkëshorten e tij Miriamin dhe vajzën 2 vjeçare Ameli. Kujtojmë se Miriami dhe vogëlushja Ameli janë larguar prej disa ditësh në Gjermani e siç kanë thënë po presin me mall babi Albanin. Urojmë që kjo shkëputje të jetë afatshkurtër, pasi çdo artist e ka të nevojshme.



Françeska Jaçe i përvëlkon të gjithë me fotot nga Dubai

Ish-banorja e 'Big Brother' është shpesh në qendër të lajmeve rozë për shkak të postimeve të shumta provokuese që bën në rrjetin e saj social. Françeska Jaçe është ndër vizitoret më të shpeshta në Dubai. Ish banorja e 'Big Brother' ka goditur edhe kësaj radhe me pamjen e saj provokuese. Ajo kujdeset të shfaqet e nxehtë dhe të zgjojë tundime. Madje nuk kursen të futë fansat në dhomën e saj të gjumit me në të postimeve që bën. E veshur me një këmishë nate mjaft seksi, Françi i la të gjithë zgjuar.



'U plake pa të dashur, të iku jeta beqare', Greta Koçi habit me përgjigjen ndaj ndjekësit

Ajo është një nga këngëtareset më të dashura të publikut shqiptar. Greta Koçi ka dashur gjatë gjithë kohës të mbajë larg ekranit jetën e saj private duke lënë të kuptohet se nuk ka dikë pranë saj. Këtë fakt ia kanë vënë në dukje edhe fansat duke i thënë se mbeti beqare. Një ndjekës në 'Instagram' i ka vënë së fundmi në dukje Gretës pikërisht këtë detaj. Ai i shkruan këngëtares se, në fakt, ajo po plakët pa të dashur, mirëpo përgjigjja e Gretës me siguri e ka lënë ndjekësin me gisht në gojë. "Së pari, qëllimi i jetës nuk është vetëm për të dashur, por të kesh dashuri me të gjithë njerëzit e zemrës, të kesh sukses dhe të jesh i zoti t'i bësh ballë jetës me dinjitet, në mënyrë që ai "Dashuria" kur të vijë tek ty, të të dojë e respektojë me tërë zemrën dhe të jetë i gatshëm që bashkë me ty të ndërtojë një jetë të bukur dhe të shëndetshme. Të garantoj që ai që do vijë drejt meje nuk do jetë i dashur, por do jetë burrë me plot kuptimin e fjalës dhe do jetë njeri me vlera dhe integritet." - shkruan këngëtarja në postim. Jo keq si përgjigje apo jo?



Nga këngëtarët ndër vite te fituesit e vjetër, ja surprizat që rezervon nata e tretë

Sot finalja e 'Fest 57', ja kush 'rrëmben' mikrofonin për në Eurovizion

Pamela Aliaj

Fundviti rezervon një nga momentet më të bukur që na nxit për të qenë më pranë me njëri-tjetrin duke festuar ndërrimin e orëve për të ardhur një vit i ri. Por jo vetëm kaq! Këtij muaji i jepen më tepër ngjyra nga festivale të ndryshme muzikore në ekranet tona. Një ndër to është edhe festivali i RTSH, i cili përveç emocioneve dhe risive që sjell me këngët e ndryshme, fituesi i saj na përfaqëson në Eurovizion. Tri netët janë tradita që shoqëron këtë event çdo vit ku dy të parat prezantojnë këngët konkurrense dhe e treta paraqet finalistët së bashku me këngën fituese. Ditën e enjte është mbajtur nata e parë e festivalit të fundvitit dhe, siç është lajmëruar edhe më herët, i ftuar special ka qenë Ermal Meta, këngëtar shqiptar që fitoi festivalin e Sanremo në vitin 2017. Siç premtoi edhe në konferencën për shtyp, artisti i njohur këndoi *live* me orkestrën e Radio Televizionit Shqiptar, dy këngët e tij më të njohura "Non mi avete fatto niente" dhe "Piccola Anima" duke emocionuar mijëra fansa që ishin të pranishëm në sallë. Por ajo që prisnin me vëmendje të gjithë ishte surpriza që Ermali kishte përgatitur për publikun shqiptar, duke bërë atë që më së shumti ëndërronim: të këndonte shqip. Ylli i muzikës risolli këngën e njohur të artistes Anita Taka "Në bankat e shkollës moj mike" të cilën e këndoi *live* në skenë së bashku me Ana Gojlën, prezantue-

Organizatorja Inva Mula shpreh idenë e zgjedhjes së finalistëve

sen e festivalit të këtij viti. Meta dhe këngëtarja kanadeze me origjinë shqiptare, si dy artistë që jetojnë jashtë kufijve 'folën' shqip përmes këngës së njohur duke ngritur në këmbë e duke rrëqethur gjithë të pranishmit në Pallatin e Kongreseve. Një moment vërtet i paharrueshëm nga ky Fest '57. Përveç Ermalit, nuk duhet të harrojmë të të veçojmë edhe prezantuesit që janë zgjedhur këtë vit për të drejtuar këtë festival të madh. Sikurse asnjëherë më parë, këtë vit në drejtim është aktrori i mirënjoh-



hur i filmave shqiptar, Viktor Zhusti si dhe këngëtarën bukurshë Ana Gojla, e cila nuk jeton në Kanada. Duke qenë se ajo jeton jashtë vendit të gjithë ishin skeptikë lidhur me faktin nëse bukurshja e kishte ruajtur sadopak gjuhën mëmë. Ana Gojla, -me një formim artistik mbreslënës, aktore, muzikante, producente, - e veshur si një rock-girl, ulur në karrige këndoi drejtpërdrejtë (na kritikon Pandi Laço, po të themi 'live') këngën "Mall" të Eugent Bushpepës, dhe të gjithë skeptikët heshtën dhe shijuan ashtu si dhe publiku performancën e saj. Së bashku me aktorin Viktor Zhusti, të cilit nuk kishte si t'i mungonte ana e një kavaliери të vërtetë në skenën shqiptare,



ata ishin shumë larg nga një prezantim formal. Kimia që kishin të dy në skenë u vu re direkt ku dhe nxori në pah një prezantim të këndshëm, që rridhte kaq natyrshëm, që fliste me gjuhën e artit, elegancës, sharmit, konçizitetit, fisnikërisë, pak ironik dhe promovues i vlerave më të mira që kemi, me pak fjalë ashtu siç na hije! Kjo falë edhe skenarit të punuar nga Pandi Laço, ku mesazhi i kultivimit dhe ruajtjes së gjuhës shqipe ishte një nga më të rëndësishmit, gjë e cila u identifikua më së miri me Anën, një vajzë që lindi në emigrim, dhe që familja i mësoi dhe edukoi shqipen si bazën e parë të formimit të saj! Më tej, interpretimi i saj në anglisht, apo edhe bashkë këndimi me Ermal Metën, në këngën shqiptare himn "Në bankat e shkollës", të Anida Takes, ishte mbyllja më e ëmbël e kësaj mbrëmjeje! Ndërsa të premtën 22 këngëtarët, që dhuruan emocion në sallë me këngët dhe interpretimin e gjallë, me orkestrën e Radio Televizionit Shqiptar, interpretuan në formatin e Eurovizionit. Gjithsesi mund të themi se gjithçka u pa nga nata e parë, ku nuk thonë kot: Fillim i mbarë, gjysma e punës! E tillë ishte dhe nata e parë dhe e dytë. Të dyja janë qartazi garancia e një suksesi që do të vijojë deri në Finalen e sotme! Ndërkaq nga ana tjetër, në një intervistë për revista 'Who', organizuesja e 'Fest 57', Inva Mula ka shpalosur surprizat që rezervon finalja. "Për herë të parë këtë vit do të ketë një natë performance. Është menduar që të prekim pak që në 'Festivalin e Këngës' skenën e madhe të 'Festivalit Europian' me performancën dhe gjithë elementët që e bëjnë spektakolar një numër artistik. Edhe



KËNGËTARËT E KUALIFIKUAR PËR NË "FEST 57" TË RTSH


1. AUREL THËLLIMI	12. KELLY
2. BOJKEN LAKO	13. KLINT ÇOLLAKU
3. BRUNO POLLOQATI	14. KLODIANA VATA
4. DILAN REKA	15. KUJTIM PRODANI
5. ELIZA HOXHA	16. LIDIA LUFI
6. ELONA ISLAMAJ	17. LORELA SEJDINI
7. ELTON DEDA	18. MARKO STRAZIMIRI & IMBRO
8. ERANDA LIBOHOVA	19. MIRUD
9. GJERGJ LEKA	20. ORGESA ZAIMI
10. GRALAR BAND	21. SONI MALAJ
11. JONIDA MALIQI	22. VIKENA KAMENICA

FESTIVALI I 57-TË I KËNGËS NË RTSH
20:28 SHPALLET LISTA E 22 KËNGËTARËVE QË DO TË MARRIN PJESË GJATË 3 NETËVE

ky është një element shumë i ri për festivalin tonë dhe unë e kam menduar sikur të isha vetë në festival. Sigurisht dhe unë do ëndërroja të isha pjesë e 'Festivalit Europian' dhe pse mos të fillojmë të mendojmë për një performancë në një skenë aq të madhe, secili në vetvete si do dëshironte që kënga të ishte. Duke filluar nga kjo mënyrë e të menduarit atëherë na doli një natë shumë e bukur, një natë per-

formancë, e cila në koncept është e tillë. Shpresoj që të jetë vërtet edhe për publikun diçka e re, por secili do ta ëndërroj veten si do të ishte në një natë 'Eurovision'-i, në një natë 'Festivalit Europian'. Për 'RTSH'-në nuk është qëllim vetëm pjesëmarrja në 'Festivalin Europian', sepse 'Festivali i Këngës' ka ekzistuar shumë më përpara se pjesëmarrja e Shqipërisë në 'Festivalin Europian'. Megjithatë është dhe një aset

shumë i madh, është një shans shumë i madh për të gjithë interpretuesit që ta realizojnë një ëndërr të tillë", ka thënë Inva Mula. Ndërkaq ndër këngët pretendente për çmimin e madh mund të ndalemi tek disa këngëtarë të mirënjohur të skenës shqiptare të cilët kanë një bagazh të gjerë artistik i cili daton prej para shumë kohësh. Ndër to do të përmendim këngëtarët më të dashura të skenës, Soni Malaj dhe Jonida Maliqi. Ashtu siç është vënë re edhe në suportin që të tjerë artistë i kanë dhënë, këto dy këngëtare duket se janë në një garë të ngushtë me njëra-tjetrën. Soni vjen si kurrë më parë me një këngë, e cila është autobiografike, "Më e fortë", dedikuar jo vetëm vetes, por edhe gjithë femrave të tjera, të cilat hasin vështirësi të mëdha dhe nuk bëjnë kompromise për të dalë nga situatat e vështira në të cilat ndodhen. Kënga e Sonit është vlerësuar shumë dhe mbrëmë në performancën e saj të parë ishte vërtetë e veçantë në stilin e saj dhe në emocionin që i dha



publikut. Ndërkaq Jonida Maliqi, me këngën "Ktheju tokës", i drejtohet të gjithë njerëzve të cilët për arsye të shumta kryesisht ekonomike vendosën të 'braktisin' vendin e tyre. Kjo këngë përmban shumë patos dhe emocion dhe është mirëpritur jo vetëm nga publiku, por edhe nga artistët brenda dhe jashtë vendit. Ndërkaq nuk duhet të harrojmë dhe artistë të rinj si Dilan Reka apo Klodiana Vata. Në mesin e artistëve pjesëmarrës spikasin emra e mëdhenj të muzikës shqiptare si Vikena Kamenica, Bojken Lako, Jonida Maliqi, Elton Deda, Eranda Libohova, Soni Malaj, Orgesa Zaimi, etj. Ajo që bie në sy në listë është rikthimi i këngëtarëve BIG në Festivalin e Këngës prej nga ku do të dalë edhe kënga që do të përfaqësojë Shqipërinë në Eurosong, ndonëse ka edhe mjaft artistë të rinj që do të konkurrojnë në festivalin e këtij viti. 22 këngët që do të marrin pjesë në netët e Festivalit të 57-të të Këngës në RTSH janë përzgjedhur nga një komision, që gjatë kësaj faze ka shqyrtuar 54 këngët që ishin regjistruar për të qenë pjesë e festës më të madhe të muzikës në Shqipëri. Pas një spektakli dy-ditor muzikor plot shkëlqim, juria e Festivalit të '57 të këngës në RTSH, ka shpallur këngëtarët që do të vazhdojnë konkurrimin në natën e tretë, të sotme ku do të shpallet edhe fituesi. Të shohim kush do të rrëmbejë mikrofonin për në mbrëmjen e sotme për të siguruar biletën për në Eurovizion!





@qendresa_bajrami

Rroa Gashi

Bëhet baba për herë të parë, ja emri i vajzës së moderatorit shqiptar

Vetëm një ditë më parë Labi dhe Qëndresa u bënë prindër për herë të parë. Ata kanë vendosur t'i vënë një emër shumë interesant vajzës së tyre. Labi dhe Qëndresa janë bërë prindër të një vajze. Ata kanë lajmëruar menjëherë për lajmin e gëzueshëm, ndërsa fansat kanë qenë kuriozë të dinë emrin që ata i kanë vënë vajzës. E Labi nuk ka vonuar, duke zbuluar se vajza ka marrë emrin Rroa, një emër ky mjaft i veçantë. Me jetë të gjatë vogëlushja Rroa Gashi!



ALBI COCAJ



'Kjo bukuroshe ka nevojë për një bishë' habit ish-banorja me deklaratën

Ajo gjithnjë ka qenë në qendër të vëmendjes edhe pse ka më tepër se një vit që nuk është më pjesë e ekranit me reality show-n e njohur 'Big Brother Albania'. Ish-banorja e 'Big Brother 9' është kthyer në vëmendje sërish me një postim së fundmi. Armela Hyseni është një nga vajzat seksi të dala nga edicioni i fundit i reality. Këtë herë ajo ka ndarë disa foto mjaft sensuale të shoqëruar me një 'deklaratë' të fortë. 'Kjo bukuroshe ka nevojë për një bishë' shkruan Armela. Deri më tani ajo nuk është përfolur për një lidhje të re dashurie. Të jetë vetëm për foton apo për diçka më tepër?



Rikthehet Mozzik rikthehet pas ardhjes në jetë të vajzës, merr surprizën në vendlindje

Vetëm pak ditë pas ardhjes në jetë të vogëlushes Hana, reperi i njohur Mozzik, nga Zvicra është kthyer në vendin e tij të lindjes, në Ferizaj. Artisti i rep muzikës, erdhi në vendlindje bashkë me të dashurën e tij Loredana Zefin dhe një tjetër person shumë të rëndësishëm në jetë. Reperin në Ferizaj e shoqëroi vajza e tij e porsalindur, Hana. Dhe në qytetin e tij ai është pritur shumë ngrohtë nga fëmijët e Mahallës. Reperi ka publikuar në profilin e tij në Instagram, një video ku shihen plot fëmijë të grumbulluar te shtëpia e tij, duke e përshëndetur.



Morning Love

"S'jam në gjak me familjen e autorëve, denoncoj prokurorin e çështjes për fshehje krimi

Masakra e Mamurrasit me 1 të vranë e 2 të plagosur, babai i viktimës: Dua drejtësi

Idriz Tafa: Dy vëllezërit Mamli kishin planifikuar ekzekutimin e tim biri

TIRANË

Ngjarja e rëndë e ndodhur në 23 shtator të vitit 2015 në Mamurras është rikthyer dje në studion e emisionit "Me zemër të hapur", në "News24", këtë herë me dëshminë e babait të viktimës, Naim Tafa. Dy vëllezërit Tom dhe Enrik Mamli janë përfshirë në një konflikt, i cili fillimisht ka qenë thjesht fizik, më pas ka degjeneruar në përplasje me armë, me një të vranë dhe dy të tjerë të plagosur. Për shkak të një mosmarrëveshjeje të dikurshme, vëllai i vogël Enriku është ndaluar nga një kushëri i viktimës, i cili i kërkonte të sqarohet. Pas refuzimit dhe përplases fizike mes tyre, ka tentuar të ikë. Në makinë kanë qenë të dy vëllezërit në momentin kur një automjet me xhama të zeza u ka prerë rrugën, incident që solli më pas përplasje me armë. Pak kohë më parë, motra e tyre, Valbona ka shpjeguar ngjarjen e rëndë, ndërsa ka thënë se 4 personat kanë qëlluar në drejtim të vëllezërve të saj dhe ata janë kundërpërgjigjur për t'u vetëmbrojtur. Sipas saj, vëllezërit nuk e njihnin fare viktimën dhe nëse do kishin planifikuar ngjarjen, do vrisnin kushëririn e tij, me të cilin e kishin konfliktin. Nga personat që ndodheshin në makinën tjetër ka mbetur një i vranë dhe për këtë arsye të dy vëllezërit ndodhen pas hekurave duke vuajtur dëminim. Valbona tha se vëllai i madh, Tom Mamli, është dënuar me shumë se i vogli, ndërkohë që ai nuk ka qëlluar fare.

Por, tjetër version dha dje babai i viktimës, Idriz Tafa. Ai dhe vëllai i tij, i cili gjithashtu ka të birin në burg për shkak të kësaj ngjarjeje kanë rrefyer një tjetër version. Ata pretendojnë se e vërteta është manipuluar dhe jo vetëm në studio, por edhe në organet e drejtësisë. Idriz Tafa deklaroi se vëllezërit Mamli e kishin planifikuar vrasjen e djalit të tij. "E gjithë nisi në një shtet të veriut të Europës, nuk më kujtohet shteti, ngatërresa është importuar në Shqipëri. Tani nuk e di kohën sa ka zgjatur ngatërresa këtu me ngatërresën atje. Që ta njohësh duhet të kesh disa faktorë, ngatërresën e mësova nga Edmondi, djali i vëllait. Unë e pyeta pse e rrahe djalin e Dodës, Enriku. Më tha 'vinte te dyqani se kishte ushqimore, më shihte shtrembët, me inat. Janë rrahur kështu me grushte. Unë do flas vetëm të vërtetën. Bashkë dy nipat e kanë rrahur, vetëm se



BABAI I VIKTIMES HEDH POSHTE VERSIONIN E 2 TË DENUARVE MAMLI



NE LIDHJE TELEFONIKE, TOM MAMLI NGA BURGU

NGJARJA E 23 SHTATORIT NË MAMURRAS

Ngjarja e rëndë ndodhi në qendër të Mamurrasit, më 23 shtator të vitit 2015, ku si pasojë e përplases me armë mbeti i vranë Naim Tafa si dhe u plagosën rastësisht shtetasit Idriz Tafa dhe Altin Çoku. Në vendin e ngjarjes u sekuestruan 12 gëzhoja fishkësh të armëve të zjarrit, 11 prej të cilave brenda në makinën e Enrik Mamlit. Kjo makinë u gjet nga policia e braktisur, rreth 300 m larg vendit të ngjarjes në përpjekje për t'u larguar.

DEKLARATA E TË DËNUARIT TOM MAMLI

Tom Mamli, i cili akuzohet si një nga autorët e masakrës së Mamurrasit, ku mbeti i vranë një person dhe u plagosën rastësisht dy të tjerë, më 4 dhjetor u bë pjesë e emisionit "Me zemër të hapur" në "News 24". Mamli, i cili është dënuar me 29 vite burg për ngjarjen, ka mohuar se ka qëlluar në drejtim të viktimës Naim Tafa. Në një lidhje telefonike nga burgu i Shën Kollës në Lezhë, i riu tha se ai dhe vëllai nuk janë kriminelë dhe se janë të pafajshëm. Po ashtu, ai mohoi se vëllai i tij, Enrik Mamli qëlloi në kushet e vetëmbrojtjes.

DEKLARATA E MOTRËS SË DY AUTORËVE

Më 4 dhjetor të këtij viti, Valbona, motra e Tom dhe Enrik Mamlit, rrëfeu në studion e "News 24" ngjarjen e rëndë dhe pasojat, të cilat po i vuan gjithë familja. Ajo tha se secili prej tyre jeton me frikën e hakmarrjes çdo ditë. Sipas saj, vëllezërit janë të pafajshëm se dhe gjithçka ka ndodhur në kushet e vetëmbrojtjes. Ajo tregon se Tomi dhe Enriku përkatësisht 36 dhe 31 vjeç gjenden të izoluar prej 3 vitesh, ndërsa i pari është dënuar me 29 vite burg dhe i vogli me 22 vjet burg.

Ishte në kërkim për vjedhje dhe mashtrim, kapet 42-vjeçari

ELBASAN - Policia e Elbasanit ka vënë në pranga një 42-vjeçar, pasi ishte shpallur në kërkim për një sërë veprash penale. Burime zyrtare nga policia bënë me dije se Kelmend Kruja, banues në lagjen "Dyle Haxhire" të Elbasanit ishte dënuar me vjedhje, mashtrim dhe drejtim të mjetit në mënyrë të parregullt. Ndalimi i tij u bë pasi Gjykata e Shkallës Parë Elbasan, në vitin 2016 e ka dënuar me 8 muaj burg për veprën penale "Vjedhje" si dhe në 16.03. 2018 ka caktuar masën e sigurisë "Arrest me burg" për veprën penale "Mashtrim". Gjithashtu, Gjykata e Shkallës Parë Tiranë, më datë 21.05.2018 e ka dënuar Krujën me 3 vite burg për veprën penale "Mashtrim" si dhe Gjykata e Shkallës Parë Sarandë më datë 20.06. 2018, e ka dënuar me 3 muaj burg, për veprën penale "Drejtim mjetei në mënyrë të parregullt". (të gjitha masat e dënimit në mungesë). Materialet u referuan në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan.



shikonte shtrembër me inat. Edhe kanë kapur dy veta, edhe të palës së tyre. Më pas kanë dashur të pajtohen. Nipi më tha mu 'o xhaxh nuk do me u pajtu'. Ai djali, Enriku ka qenë i lëvizshëm, 5% ka faj djali im, 95% ka ai. Unë shkova vetë tek shtëpia e vëllezërve Mamli. U thashë a është mundësia me u rregullu, ishte shumë i gatshëm, me këto llafe unë dola. Kur ndodhi ngjarja, pashë një njeri të shtirë dhe i thashë jepi ndihmën se e ka shkelur makina. Në atë momente ka ardhur një makinë, kanë qenë këto tre vëllezërit, për këtë gjë mbaj përgjegjësi pe-

nale dhe kam parë dy gryka zjarr, por do fati nganjëherë. Nuk jam rrëzuar, kam rënë kështu, nuk e kuptova se jam plagos, kam shkuar me ambulancë në spitalin ushtarak. Unë kam ardhur të akuzoj prokurorin e çështjes së seancës. O unë në burg, ose prokurori i seancës. Më tha femija jote i ka gjuajtur dhe u ka ikur timoni. I thashë nuk është e vërtetë, do e kërkoj të drejtën time në instanca më të larta. Unë i kallëzoi për fshehje krimi. Unë nuk jam në gjak me familjen Mamli, unë dua të bëhet drejtësi", deklaroi Idriz Tafa.

Makina përplas mësuesen dhe nxënësen 16-vjeçare afër shkollës, shoqërohet shoferi

LEZHË - Një aksident ka ndodhur paraditen e djeshme në qytetin e Lezhës. Burime zyrtare nga policia lokale bënë me dije se një nxënëse dhe një mësuese janë përplasur nga një automjet përballë shkollës "Kolin Gjoka", teksa po kalonin rrugën për të shkuar në shkollë. Bëhet fjalë për nxënëses 16-vjeçare B. Cupi dhe mësue-



sen Elidona Gega, 23 vjeçe, të cilat janë dërguar janë dërguar urgjentisht në

spitalin Rajonal të Lezhës dhe sipas informacioneve të para ndodhen jashtë rrezikut për jetën. Pas sinjalizimit për aksidentin, policia ka shkuar menjëherë në vendin e ngjarjes dhe ka shoqëruar drejtuesin e mjetit në komisarjat, ndërkohë që kanë nisur hetimet për zbardhjen e rrethanave të aksidentit.

Opinion i Ditës

Shumë samite, pak rezultate

Nga Jorgji KOTE

(vijon nga faqja 1)

...arritjet dhe rëndësinë e takimeve/samiteve të kësaj natyre, atë e kanë zbehur ndjeshëm ngecja dhe regresi në terren; për pasojë, ato rrezikojnë të kthehen në rutinë diplomatike me interes dhe jehonë publike/mediatike minimale. Kjo duket dhe në njoftimet skematike të BE-së, ku fare pak thuhet se çndodh aty, me të mirat dhe problemet, edhe kur janë informale si takimi në fjalë. Edhe look-u i protagonistëve dhe foto familjare është larg përmbajtjes së vërtetë, siç ndodhi dhe këtë radhë, ku ra në sy dhe mungesa e Kryeministrit Rama për shkak të protestave studentore.

Le ta themi qysh në fillim se për nga shpeshësia e tyre Samitet e Ballkanit Perëndimor janë bërë si "samite". Vështirë dhe për diplomatët të mbajnë mend e të riprodhojnë saktë emrat e tyre gjeografikë: Forumi në Bled, në Zagreb, Samiti i Ohrit, i Sarajevos dhe Durrësit tonë. Veç samiteve rajonale në të gjitha kryeqytetet e rajonit dhe pothuajse në të gjitha forumet ndërkombëtare të OKB-së, BE-së, OSBE-së, Këshillit të Evropës, Davos, Munihi dhe gjetkë. Por dhe të ftuar në Aspen, Gjermani, Graz, Austri dhe gjetkë. Këto pesë vitet e fundit janë shtuar dhe samitet vjetore rajonale në kuadrin e Procesit të Berlinit në (Berlin, Triste, Londër, Paris dhe Varshavë.) Shtu këtu dhe vizitat/takimet dy, tri dhe katërpalëshe dhe "inflationi" i samiteve të/dhe mbi Ballkanin Perëndimor bëhet më i plotë.

Pa qenë nevoja t'i hysh shifra, mund të thuhet se liderët e Rajonit tonë thejnë rekord duke u takuar mesatarisht pothuajse çdo javë me drejtuesit më të lartë të BE-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare!

Natyrisht asgjë e keqe nuk vjen nga dialogu dhe këto samite. Por problemi është të masa, që ajo të mos i kundërvihet thënies së urtë "gjella me kripë dhe kripa me karar".

Gjithsesi, shqetësimi më i madh në këtë mes është deficit në rezultatet e serialit të takimeve/samiteve/forumeve në fjalë, shkurt efektiviteti i tyre; kjo e fundit e "përkthyer" mbi të gjitha të klima dhe dialogu politik në rajon; me një fjalë, a është kjo klimë/mjedis politik/publik/mediatik më e ngrohtë apo më e ftohtë, madje e acartë? Mbi të gjitha, cili është produkti përfundimtar e sidomos ndryshimi që kanë sjellë këto forume krahasuar me vite më parë? Apo janë kthyer më shumë në "zjarrfikës" të flakëve që ndizen fill pas tyre?

Me këtë rast del në pah dhe vetë performanca e zonjës Mogherini, që me të drejtë e ka vlerë-



suar si përparësi dhe me predispozicion pozitiv Ballkanin Perëndimor, ndonëse ajo përgjigjet për shumë rajone e zona të tjera. Aq më tepër që e ka vitin e fundit të punës, pasi ka shpallur se nuk do të kandidojë më. Mirë ka bërë, sepse dhe sikur të donte, kjo do të ishte mision i pamundur. Partia Demokratike që e propozoi në këtë funksion mezi po mbahet në këmbë pas disfatës në zgjedhjet parlamentare më 4 mars 2018, plus e panjohura e madhe në zgjedhjet e reja për Parlamentin Evropian pas "yryshit" të forcave populiste dhe ekstremiste që janë në pushtet dhe në Italinë e Mogherinit.

E pra, pikërisht ky produkt, si treguesi i vërtetë i efektivitetit politik/diplomatik të BE-së dhe Zonjës Mogherini është pak i dukshëm dhe i prekshëm, për të mos thënë të kundërtën. Marrëveshja e Prespës është ngjarje e shumëpritur dhe që i kalon caqet e BE-së, e megjithatë duhet pritur ende.

Veç kësaj, këto samite të shpeshta e bëjnë të pamundur "përtypjen" e kërkesave dhe objektivave; dhe më i vështirë është bërë për follow up i tyre, sepse ende pa u zgjidhur një çështje, plas tjetra.

Për pasojë, zbehet dhe vetë autoriteti institucional i mikpritësve që duke u bërë "si i shqipësisë," shejt ua "pinë lëngun" dhe mysafirët me ta mund të sillen sipas humorit kur gdhihen, madje t'i shkojnë në takim dhe me atlete apo aksesorë jashtë pro-

tokollit, në emër të atipizmit politik! Kur, në fakt, samiti dhe nga vetë emri (maja e malit) është moment kulminant që pas arritjeve dhe sfidave bën analiza dhe përcaktat objektivat për të ardhmen, veçse pa kthim prapa.

Ndaj kur thërret një takim të nivelit më të lartë, gofë dhe informal, kushdo duhet "t'i thërrasë mendjes" mirë, sidomos me liderët të Ballkanit Perëndimor, të cilët që nuk përtojnë t'i japin mend dhe Europës qysh tani pa çelur ende negociatat e anëtarësimit!

Dihet se me sa interes u prit Samiti i BE-së Sofjes në maj për mesazhet e rëndësishme të mbështetjes së zgjerimit të saj drejt rajonit tonë. Megjithatë, vetëm me dy orë kalimthi, të paqarta dhe të pakëndshme për perspektivën e tij, Sofja ra shumë më poshtë se Selaniku i 15 viteve më parë. Bashkë me Strategjinë e re të Komisionit Evropian që, le ta themi, e në shumë vende nuk u mor seriozisht, madje u konsiderua si "shaka" e Komisionit Evropian. "Ngushëllimi" i vetëm për ne, zonjën Mogherini dhe Komisionerin Hahn që na "rrëzuan" dy muaj pas atij samiti të vakët mbeti shtyrja dhe fiksimi i një date dhe ajo indikative për çeljen e negociatave për vitin e ardhshëm dhe shpresa nëse ndoshta do të bëhet diçka në Samitin e Zagrebit 2021.

Nuk mund të quhet dështim, por dhe nuk dimë çfarë emri t'i vëmë, pavarësisht nga disa hapa dhe arritjet, dialogut Serbi - Kos-

ovë që vijon për mbi pesë vjet me ndërmjetësimin e drejtpërdrejt të Zonjës Mogherini.

Edhe pas gjithë këtyre takimeve dhe samiteve "historike" ndërmjet liderëve të vendeve tona, me gjithë hapat dhe disa arritje, ky mjedis dhe dialog ka mbetur në vend, për të mos thënë se po pëson regres. Tensionimi i paprecedentë i takimit Mogherini - Haradinajt këtë të hënë në Bruksel dhe anulimi i konferencës së tyre të shtypit ishte dëshmi më e fundit.

Pa mohuar kusuret dhe gjynahet e Kosovës të përmendura dhe më parë, Mogherini ka pjesën e saj të madhe të përgjegjësisë, veç të tjerash për shkak të qëndrimeve të njëanshme ndaj Serbisë, me gjithë pozicionet refraktare/regresive të kësaj të fundit dhe ndaj shumë hapave/demarsheve të BE-së, SHBA-ve, Kosovës, Shqipërisë, etj.

Për pasojë, ajo ka humbur shumë nga besueshmëria e saj institucionale/personale. Kësaj, me gjithë demarshet dhe përpjekjet e saj që janë për t'u vlerësuar, ky dialog vazhdon të bëhet në një truall dhe mjedis të helmuar për të përdorur termin me të butë; kjo shihet lehtë në gjuhën e urrëjtjes dhe retorikën ultranacionaliste fill pas këtyre takimeve dhe në refrenin politik serb se "kurrë nuk do ta njohim Kosovën", lobimi e saj agresiv për çnjohjen e Kosovës, etj.

Kështu, ndërsa në Bruksel zhvillohet dialogu politik Prishtinë - Beograd nën kujdesin e Mogherinit, Serbia zhvillon gjithandaj "përleshje" diplomatike dhe verbale kundër anëtarësimin të Kosovës në UNESCO dhe Interpol?

Apo kur më 14 Qershor të këtij viti qeveria serbe inauguroi me "pompë" memorialin kushtuar milicëve dhe ushtarakëve serbë të vrarë në genocidin e pashembullt ndaj shqiptarëve në pranverë 1999? Madje, duke i glorifikuar ato beteja si "termopilet serbe"! Ndërsa në Tetovë, në Panairin e 63 Ndërkombëtarë të Librit në Beograd u promovuan me bujë libra të ushtarakëve të lartë serbë, ndërmjet tyre të N. Pavkoviç, i cili po kryen në Finlandë dënimin me 22 vite burg që i dha Haga për krime dhe genocid ndaj vëllezërve të Kosovës dhe këtë qarqet serbe e konsiderojnë heroizëm!

Nuk e dimë a i sheh këto realitete Mogherini me bashkëpunëtorët e saj, sepse nuk kemi dëgjuar që të ketë thënë ndonjë një fjalë e ca më pak t'i ketë tërhequr veshin liderëve serbë për këto dhe të tjera raste! Shpresojmë që dhe fraza e njoftimit për shtyp mbi takimin e 19 dhjetorit kundër qëndrimeve dhe deklarimeve provokuese ndaj interesave dhe objektivave strategjike të rajonit t'i referohet në radhë të parë liderëve serbë, si shkak u qëndrimeve dhe masave më të fundit të njohura të autoriteteve të Kosovës; këto të fundit janë pasoja të politikave nacionaliste serbe që duket se po "mbahen me hatër" dhe nga Mogherini.

Kjo vlen dhe për idenë lidhur me korigjimin e kufijve, që u hodh në "tregun" politik të Kosovës dhe më gjerë pa konsultim e durura me institucionet dhe protagonistët e tjerë të brendshëm dhe të jashtëm, si kusht dhe kriteri themelor për t'u bërë i pranueshëm nga opinioni i gjerë publik. Sepse, siç pohon emblematiku Kissinger "Asnjë politikë e jashtëm, sado e gjetur të jetë, nuk ka shans për sukses në rast se lind në mendjet e pak njerëzve dhe nuk prek zemrën e askujt".

Në rastin e Kosovës, krahas suksesit të mundshëm, duhet marrë parasysh e parandaluar dhe rreziku i madh që në emër të një Marrëveshjeje të sforcuar të detyrueshme me Serbinë të dëmtohet dhe prishet dialogu dhe stabiliteti i brendshëm politik në Kosovë dhe gjetkë. Për pasojë gjithë procesi dhe arritjet e deritanishme, të brishta siç janë mund të kompromentohen.

Ja pse Takimi më 19 dhjetor nuk ishte as ngjarje dhe as lajm si në raste të mëparshme. I vetmi dallim është se ai u zhvillua në pragun e festave të fund vitit; kur grindjet dhe mëritë e çdo lloji sfumohen për pak kohë në atmosferën gazmore të fiskekzjarrëve, shampanjës, Pemës e pse jo dhe pakume dhe dhuratat e Krishtlindjeve.

Opinion *i* Ditës

Drejtimi që do të marrë populizmi në Europë në vitin 2019

Nga Henry Rdigewell

(vijon nga faqja 1)

... Në Francë, protestat nëpër rrugë shpërthyen me kërkesa për dorëheqjen e presidentit. Vala populiste mund të ketë implikime të mëdha në zgjedhjet e Parlamentit Europian, të parashikuara për vitin 2019 ku forcat centriste përballen me sulme si nga e djathta, ashtu edhe e majta.

Në fund të vitit 2018, populizmi në Europë ka një ngjyrë të re: të verdhë.

Lëvizja e "jelekëve të verdhë" shpërtheu në Francë, si protestë kundër taksave për karburantin dhe u shndërrua në demonstrata në gjithë vendin.

"Bëhet fjalë për njerëz të vërtetë, jo njerëz që shtrihen sikur janë diçka që nuk janë", thotë Jean-Francois, një protestues.

Presidenti Emmanuel Macron, që dikur shihej si njeriu që frenoi marshimin e populizmit, u tërhoq duke shtyrë ngritjen e taksave.

Ç'do të thotë kjo? Që populizmi është kthyer në forcë politike.

"2018-a ishte viti i rikthimit të valës. Unë mendoj se ishte gabim të besohesh se vala ishte ndalur. Në fakt, thjesht ishte fshehur pas Macronit", thotë Grégory Claeys, i Institutit Bruegel për Politikë.

Por populizmi i 2018-së ka një ndryshim. E djathta ekstreme dhe e majta ekstreme marshuan së bashku.

"Më parë shihnim populizëm të krahut të djathtë, kryesisht në Evropën Lindore dhe kjo falë frikës së imigracionit dhe çështjeve të identitetit, ndërsa në jugun e Evropës, kishim më shumë populizëm të majtë, sepse ky është rajoni që është prekur më shumë nga kriza financiare, kriza e Euros e të tjera. Prandaj të dyja janë si të veçanta. Por tani shikojmë në vende si Italia dhe Franca, i kemi të dyja njëkohësisht", thotë zoti Claeys.

Kjo lloj bashkëjetese u zyrtarizua në Itali, kur Lëvizja e krahut të majtë Pesë Yjet dhe Liga e së djathtës ekstreme, formuan një qeveri koalicioni në maj.



Kauza e tyre e përbashkët: ndalja e valës së imigrantëve në brigjet italiane dhe ndërprerja e shkurtimit të shpenzimeve. Kjo e ka vënë Romën në konflikt me Bashkimin Evropian.

Ministri i Brendshëm, Matteo Salvini, që shihet këtu me udhëheqësen e së djathtës ekstreme të Francës Marie Le Pen, është bërë fytyra e populizmit kundër BE-së.

"Armiqtë e Europës, janë ata që janë mbyllur në bunkerin e Brukselit", thotë ai.

Tronditur nga tërmetet politike, Bashkimi Europian ka

paralajmëruar se liritë themelore janë në shënjestër.

"Jetojmë në një botë të karakterizuar nga rindija e forcave populiste dhe retorikës shkatërruese", shprehet Antonio Tajani, Presidenti i Parlamentit Europian.

Në Spanjë, që dikur shihej si e imunizuar nga politika e së djathtës ekstreme, partia populiste 'Vox' po forcohet.

"Këto lëvizje politike nuk do të shuhën. Ato do të jenë këtu për dekada të tëra".

Por popullsitë kanë konkurrencë. Partia e Gjellbër pro-evropiane,

është fuqizuar në Gjermani, duke e ulur "Alternativën për Gjermaninë" të së djathtës ekstreme në vend të katërt.

Në Hungari, protestat e rrugëve kanë shpërthyer kundër qeverisë populiste të Viktor Orbanit.

Copëzimi i politikës europiane, mund të ketë implikime të mëdha për zgjedhjet e Parlamentit Europian, në maj 2019.

Pasi kanë fituar terren në disa kryeqytete në gjithë Evropën, në vitin 2019 forcat populiste do të përpiqen të marrin frenat e pushtetit edhe në vetë Bashkimin Europian. /VOA/

BalkanWebJ.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT MË VIDEO DHE FOTO NGA VENDGJARJA. ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA MË NJË KLIKIM.

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NË MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ

HOROSKOPI

DASHI

Në momentin e caktuar kërkon këshillën e dikujt, para se t'i futeni një aksioni të ri financiar. Pas investimeve të mëdha, do të pasojnë shpërblimet e mira dhe rezultatet pozitive.

DEMI

Është e mundur që partneri të shfaqë pakënaqësi apo të përpiqet t'ju bindë të mendoni ndryshe. Mundohuni që ta kapërcëni shqetësimin apo krizën emocionale.

BINJAKET

Është me rëndësi të ruani energjinë e brendshme. Largimi i përkohshëm nga personi i dashur apo distanca emocionale duhet t'ju motivojnë të merrni vendimin e duhur.

GAFORJA

Çdo gjë zgjidhet mirë, sipas parimit të marrëveshjes dhe emocioneve të përbashkëta. Bëni çdo gjë që është e nevojshme që të mbroini lumturinë tuaj dashurore dhe personin të cilin doni.

LUANI

Jeni në fazë kreative dhe është me rëndësi që t'i përcaktoni qëllimet tuaja financiare në marrëveshje me bashkëpunëtorët besnikë. Verifikoni informacionet e reja në skenën ekonomike.

VIRGJERESHA

Është e nevojshme që të krijoni paraqitje më të mirë profesionale; e cila do t'ju mundësojë që në mënyrë të arsyeshme t'ua impononi rolin tuaj bashkëpunëtorëve.

PESHORJA

Çështja e organizimit afarist dhe besimit të disa bashkëpunëtorëve kërkon që të mendoheni mirë para se të vendosni për strategjinë bazë. Mos lejoni që t'ju pengojnë disa ngjarje dytësore.

AKREPI

Sapo të gjendeni një hap afër zgjidhjes, tek ju lind një dilemë e re emocionale. Është e qartë që "shkëlqimi i dashurisë" në çast nuk paraqet lumturinë e vërtetë, të cilën po e kërkon.

SHIGJETARI

Po ju mungon mirëkuptimi i një personi, keni bindjen sikur po largoheni nga dikush që është shumë i dashur për ju. Nëse jeni i ri apo i lirë, aventurat dashurore më shumë do të jenë afatshkurtra.

BRICJAPI

Te vetja po nxisni kureshtjen kreative dhe vetëbesimin si afësi plotësuese për avancim të shpejtuar profesional. Është e nevojshme që t'i zgjeroni dijet horizontin dhe që t'u përshatani kushteve të ndryshme afariste.

UJORI

Pas angazhimit të madh, do të pasojnë rezultate pozitive. Me krenari dhe pa modesti të rreme mund të arrini suksesin tuaj profesional.

PESHQIT

Kushtojni kujdes takimeve të ndryshme, ofertave dhe kontakteve me botën e jashtme. Dikush është i gatshëm që t'i përkrahë apo t'i shpërblejë idetë tuaja origjinale.

KUJTESE

GËZIM QËNDRO

"Të shkruarit, si lutja"

A i ishte një figurë jashtë kohës, por shumë i domosdoshëm për kohën". Tek e thotë këtë konkluzion të përmbledhur për Gëzim Qëndron, Besim Tula e ka fjalën për përmasën kulturore dhe intelektuale të studiuesit. Piktori e shih studiuesin si të parin që hapi një rrugë... rrugë të cilën, Qëndro vetë besonte se arti pamor, në aspektin studimor, duhej ta shtronte, doemos. Sigurisht, siç thotë Tula: "Seriozitetin shkencor, grumbullimin e fakteve duke shkruar në origjinin e gjërave, interpretimin e aktit artistik të veprës, që ka qenë një punë e gjatë me shumë skrupulozitet. Ai e gurmonte faktin deri në detaj. Rruga e lehtë për të ishte e huaj".

Përgjatë kësaj rruge, Qëndro vendosi gurët e tij miliardë, ekspozita, koncepte, studime, libra... Duhet të kishte një qenë në rrugë e sipër ende, në fakt, duke vazhduar të lërë shenjat e tij, të domosdoshme për artin në Shqipëri, por realiteti është i egër, shpesh, i paparashikueshëm, pengues. Kështu edhe për Gëzim Qëndron.

Sot mund të kishim realizuar një intervistë me të, që do të kishte të bënte me librin e radhës, por na duhet të kthejmë kokën pas e të ndalim në një intervistë të dikurshme. Sot, më 22 dhjetor, në 61-vjetorin e lindjes së Gëzimit Qëndros, po zbardhim një intervistë me Diana Çulën, ku studiuesi rrefen për veten, punën, pasionin që ai, siç thotë, nuk e dimte kush ia bëri dhuratë, por ç'rëndësi ka... Ai e pati dhuratën e tij, kënaqësinë e punës së përditshme intelektuale me "T" të madhe.

- Keni përdorur shumë dhe vazhdoni të punoni. Pak më parë të bisedonim, po thoshim se nuk del koha për kaq shumë punë në ditë që bën njeriu, për atë që do të punojë, apo jo?

Gëzim Qëndro: - Pikërisht. Unë e shoh punën e studiuesit si atë të një punëtorit që cohet në pengesën fillon ditën dhe në fund të saj sheh ç'ka bërë. Të nesërmen fillon prapë. Se puna intelektuale kërkon përditë të punosm. Më vjen në mendje ajo shprehja e njohur: të shkruarit është si lutja. Zoti të zemërohet nëse nuk iutësh përditë. Kështu është. Nuk e di se kush do të zemërohet në këtë rast, por mendoj që kemi një detyrim që përditë të bëjmë detyrën tonë. Ajo që nuk e kam kuptuar dhe akoma nuk e kam të qartë është nëse mund t'i thuasht dikujt që je punëtor apo jo. Pra, s'di nëse unë jam punëtor. Sepse e shoh shpesh herë veten të paaftë të bëj gjëra që nuk më pëlqejnë. Mendoj që kryesorja është jo vullneti, por pasioni. Nëse do t'i urosh dikujt diçka, duhet t'i urosh pasion. Në momentin që ai ka pasionin, nuk sheh as orët që kalojnë, nuk sheh asgjë.

- E vërtetë, edhe lodhja është më e vështirë.
Sigurisht. Kam përshypjen se si vullneti, pra kur detyron veten të bësh diçka, sidomos në punën krijuese, nuk funksionon. Nëse nuk është pasioni brenda, gjithçka tjetër zhvlerësohet. Nganjëherë, kur më thonë je me vullnet, u them se nuk besoj të jetë kështu. Se vullneti është të bësh diçka që nuk të pëlqen, ta detyrosh veten ta bësh. Ndryshe është me pasionin.

- Le të themi që është fat që njeriu ta dojë shumë punën e vet.

Pikërisht dhe e bukura është që pasionet të zgjedhin, nuk je ti që i zgjedh. Prandaj është fat, sepse nuk e kam bërë unë zgjedhjen. Nuk e di përse nga mosha 10-11 vjeç doja të bëhesha piktor. As në traditën e familjes nuk e kisha, as të fisit, as në mendojta që do të bëhesha. Në fakt nuk jam piktor, s'u bëra dot, por u bëra studiues. Megjithatë për vite me radhë jam trajnuar si piktor, erdhi një moment që më duhej të bëja një zgjedhje ose këtej, ose aty dhe zgjedha këtë që e kam më për zemër. E quaj veten me fat në kuptimin që e kam këtë pasion që, siç thashë, nuk e di nga ka ardhur. Nuk e di kush ma bëri dhuratë, por ç'rëndësi ka. Po më mban gjithë jetën dhe tani vërshtirë që do më lërë se po i afrohem të 60-ave.

- Jo, tani jo. Tani s'ju lëmë, as ju s'e lini dot më tani.

Jo. Në mëngjes kur cohem e filloj ditën me shumë kënaqësi, sepse kam gjëra për të bërë që më pëlqejnë.

- Sot e keni kanalizuar jetën tuaj që të bëni këtë gjë që ju pëlqen dhe keni nxjerrë produkte shumë interesante dhe shumë të dobishme për të gjithë studiuesit dhe studentët të cilëve ju jepni mësim. Keni botuar shumë libra. Unë do ta filloja këtë bisedë, këtë rrugëtim me ju, me një nga veprat tuaja "Gjuha pamore" ku merreni me imazhin, me artet pamore... le t'ia nisim nga simboli në kopertinë.
Është vizatim i një piktori të njohur (Fig.1),

Escher quhet, i cili ka bërë gjithmonë lojëra të tillë pamore. Po ta vini re, ai ka marrë një sferë ku duket edhe ai vetë që e mban në dorë. Qysh në këtë moment hapet një diskutim mbi perceptimin.

- Ju e diskutoni këtë
Po, ka të bëjë me realitetin e tërthortë dhe të drejtpërdrejtë. U njoha në Holandë me këtë koncept se nuk e njihja më parë. Më vjen në mend tani që, kur u ktheva nga Holanda në vitin '96, më tha dikush: Je emëndur që vjen në '96 në Shqipëri, s'është koha për të ardhur.

- Më shumë kërkonin të iknin.
Edhe unë vija pas gjashtë vitësh atje. I thashë, se kisha shumë dëshirë që të bëja gjuhën pamore dhe filozofinë e artit. Ai qeshi, sigurisht. Por, kur e mendoj sot them, mbase ia ka vlejtur. E kam fjalën që në Shqipëri, e kisha vënë re atëherë e tani e vë re shumë më tepër, që ka një lloj analfabetizmi pamor. Në kulturën tonë, e kemi shumë logocentrisht. Fjala është e para. Fëmijët kur janë të vegjël, pa shkuar në shkollë, i bombardojmë me lapsa, me letra, u themi të vizatojmë. Në momentin që mësojnë të shkruajnë u themi: lërin këto. Pra, duket sikur gjuha pamore është për të kaluar kohën. Ndërkohë studimet thonë se gjysma e trurit merret me imazhin dhe gjysma tjetër me shkruarim. Në këtë mënyrë, duke mos e njohur apo vënë në punë gjuhën pamore, e lemë gjysmën e trurit të lërë gjumë. Ne, gjatë gjithë kohës kuptojmë dhe lexojmë imazhe, jo vetëm fjale. Dhe, përfytyron

sa i rëndësishëm bëhet ky analfabetizëm, sa dëmtohet në rastin e artistëve pamorë, të të gjitha llojeve. Pra, është një gjuhë që duhet lexuar. Imazhi ka një gramatikë të vetën, një sintaksë të vetën. Ne gjithmonë jemi mësuar ta kapim me intuitivë, me vesh. Por, në fakt, nuk është kështu. Ai ka gramatikën e vet. Është njëjloj si me një shkrimtar që nuk di shkronjat.

- Ose një muzikant që nuk njih notat.
Po, dhe luan me vesh. Në momentin që i hyn problematikës, atëherë kupton që janë aq shumë... Kur diskutojmë, i pyes studentët: dhome që po shkoni është jashtë jush apo brenda jush? Jashtë sigurisht, por po shohim diçka që është brenda kokës sonë. Pastaj nëpërmjet konceptit të hapësirës, ne e nxjerrim atë jashtë vetes. Edhe gjërat në të vetvetishme, më të rëndomshta që në i marrim për të mirëgëna, në fakt nuk janë ashtu, janë shumë të ndërlikuar dhe të gjitha ndikojnë në mënyrën e perceptimit dhe sidomos të konceptimit të një vepre. Pastaj hapen diskutime të tjera: procesi i shikimit, retina, makula, marrëdhënia figurë-sfond. Pra, janë kaq shumë problemet me të cilat, kur përballemi, kuptojmë që i paskemi rënë me vesh. Sepse qenka një gramatikë që duhet mësuar vërtet.

Libri ka deri tani të botuar pjesën e parë. Ka dhe një pjesë të dytë për të cilën unë po punoj dhe shpresoj të mos shkojë në kalendat greke...
- Ndërsa unë mendova, kur lexova librin tuaj, se sa shumë i ka munguar teorinë e artit tonë kë mënyrë të studiuarit, kjo gramatikë.
Po, besoj që jo. Profesionsistët duhet ta njohin patjetër, absolutisht patjetër.
- Ju e ndërthuri shumë mirë dhe me filozofinë.
Nuk ndahet filozofia.
- Nuk ndahen dhe sipas meje shumë mirë që nuk mbetet vetëm leksion për studentët, por botohet edhe si libër.
Dhe sidomos mendoj që duhet ditur nga piktorët. Për fat të keq, ne u ulëm në tryezën e dijes shumë vonë. Në momentin që ne u ulëm, në '90, kaloi gjithë modernizmi pa e njohur fare. Ne gjetëm poststrukturalizmin. Kaloi dhe strukturalizmi i Sosyrit. Unë e quaj veten me fat, nëse mund të them kështu, që vajta dhe e lexova atje. Po të mos kisha shkuar në Hollandë do ta kisha pasur shumë të vështirë.

- Kur ju ishit ende shumë i ri.
I ri. Duke shkruar atje hyra në një program. Sepse mund të lexosh vetë, tani unë mund të lexoj vetë, por atëherë nuk e kapa dot duke lexuar në mënyrë autodidaktike. Pedagogjia ka një ekonomi të mësimt. Në kohën më të shkurtër, të jep informacion më të madh edhe të strukturuar. Kurse kur merr autoritë të ndryshëm pa pasur një strukturë, është shumë e vështirë të orjentohesh.

- Është një mënyrë empirike që na ndodhi të gjithëve. Edhe ne të fushës së letërsisë, ose të gjithë shkencave humane. Na mungonte bagazhi filozofik dhe filluam t'i lexonim në vitet '90 të gjithë filozofët, sic i gjenim, në gjuhë të huaj ose dhe në përkthim. Por nuk është e njëta gjë si kur i merr të strukturuar në mënyrë pedagogjike. Nuk është e njëjta gjë, keni të drejtë... Ju jeni dhe autori i një libri shumë interesant "Të rriturit janë të uritur" (Fig.2). Edhe titulli është shumë i bukur. Në studimin tuaj jeni nisur nga tabloja e famshme e Spiro Xegës "Ceta e Shanin Matraku". Edhe unë, siç thonin ju për veten, e kam parë që e vogël këtë pikur, por nuk e kam zëbërthyer dhe nuk e kam kuptuar kurrë ashtu si ju e keni zëbërthyer.

Është realisht një kujtim i fëmijërisë. Ishte koha kur gjëja të tempujt, si çdo besimtar që kërkon të gjete tempujt. I pari tempull ishte "Lidhja e Shkrimtarëve". Tempulli i dytë, se po i quaj kështu në mënyrë metaforike, ishte "Galeria Kombëtare" në rrugë "Fortuna". Shkoja rregullisht. Ishte gjithmonë bosh. Për fat të keq, nuk mbaj mend të ketë ardhur ndonjë vizitor. Unë merrja dosjen dhe vizatoja tërë kohën. Më kujtohet, e kam thënë edhe herë të tjera, roja e galerisë, një grua e moshuar, shumë e mirë që kur ishte ftohtë më tërërisht. Kishte një furnelë dhe ngroheshim të dy. Më pyeste për prindërit, siç pyeten zakonisht fëmijët e vegjël. "Ceta e Shanin Matraku" asokohe më tërhiqte shumë vëmendjen, merret me mend, duke qenë fillestar, fëmijë, amator, ajo që më pëlqente shumë ishte mënyra se e kishte realizuar autori, me skrupulozitet gjithçka.

- Çdo detaj?
Po. Çdo detaj. Sot më duket diçka që nuk ia negru verlat, ia ul, por në atë kohë isha i magjepsur. Me "Skënderbeun", po ashtu. Kanë qenë



ngjitur të dyja punët. "Cetën e Shanin Matraku" e kam parë rregullisht më pas. Por, një ditë, krejt rastësisht, vura re një detaj të vogël që ishte ulja e dy kapadaneve në të njëjtën gunë.

- Ju e keni shpjeguar në libër edhe faktin që ata të dy si gjafësi, si lartësi, janë në vijë të drejtë.

Po po, Xega është perfekt në çdo detaj. Është një regjisor i përkryer dhe nuk mund të ishin rastësore detajet. Por fillimisht shtrua pyetjen se si ishte e mundur që dy vetë të ishin ulur në të njëjtën gunë? Se një gunë është një fron mbretit. Gjithashtu, të dy kapadanët vegohesh nga figurat e tjera sepse janë vendosur përballë. Spiro Xega ka puntuar në Stamboll si ikonograf dhe e njihje shumë mirë gjuhën e ikonografisë. Dhe në ikonografi sa më i rëndësishëm një person, aq më përballë. Kështu, personazhet e gunës janë përballë që do të thotë se janë më të rëndësishëm se të tjerët. Por, edhe duke qenë të dy të rëndësishëm, ka një dallim mes tyre. Po t'i vesh re, njeri është pak më në profil. Dhe jo vetëm kaq, personi përballë që është akoma më dinjitoz, është i vetmi që mban një faqore. Këtyrë të gjysmë profilit, s'i lejohej...
- Nuk u lejohej një kaçakëve apo...

U lejohej një kaçakëve, por duhej të fillonte kapadani i pari bijen. Pra, është një shoqëri hierarkike ku riti vendos rregullin dhe e mban rregullin. Duke parë këto detaje mendova të kërkoja vërtetimin. Ku t'i gjeja? Rreth dy vjet kam kërkuar dhe më në fund më ra në dorë libri i Gjerasim Qiriazit. Ku ai thotë se çeta ka dy kapadane. Pra, Spiro Xega i ka parë të ulur të dy bashkë.

- Se Gjerasimin e kishin rrembyer këta.

Po. E kishin rrembyer më 1884 dhe e kanë mbajtur 6 muaj, nga tetori deri në prill. Pra, prej Gjerasimit zbulova detajin e parë. Pastaj do të detaj pas detaji. Është hera e parë që unë gjeja një cif të tillë kulturore si ky libër dhe kjo tablo me një lloj sinergie midis tyre, të jashtëzakonshme. Pra, Gjerasimi thotë të vërtetën. Pastaj nga gjithë kjo histori dot diçka tjetër. Doli që kjo nuk është tablo heroike, por është tabloja e parë realiste ku tregohet gjithçka pa fshehur asgjë. Çfarë është realizmi? Aty unë përmend edhe Manifestin e realizmit të Gustav Courbet-së i cili thotë: më tregoni një engjëll që ta pikuroj. Pra, në qoftë se s'ka engjëj si mund t'i pikuroj? "Ceta e Shanin Matraku" ka një tisi romantik, për hir të së vërtetës. Por tema është përcautuese e sidomos ndershmëria. Unë mendoj se është tabloja më e ndershme që kemi. Nuk kemi asnjë tablo tjetër, që të tregojë me një saktësi të tillë zakonet e kohës. Në libër p.sh. përmendet kodi i cubnisë. Grekët kanë E.Moskonisios që e kodifikoi me 16 nene dhe 9 prej tyre kishin lidhje me pengmarrjen. Tregon si i pritje koha pengut për të mos sillëshin paratë që kërkoheshin për të, se si gjymtohej nëse jepej vetëm gjysma e parave...
- E kishte gjithë treva jugore këtë edhe grekët edhe shqiptarë njësoj?

Edhe grekët, edhe shqiptarët edhe Maqedonia, edhe Bullgaria, të gjithë, Turqia po ashtu. Nga kërkimet kuptova se kaçakët, Xega i kishte miq. Ai i ka njohur. Me Kajo Babjënin, kishin miqësi shumë të madhe, kishin hyrje-dalje. Dhe, me një lloj ndershmërie duket sikur thotë: po, ju keni vjedhur! Atë qengjin që po hani, ju e keni vjedhur! Mbase ai në atë kohë nuk e mendonte kaq të rëndë këtë gjë.

- Sepse ishte një tjetër konceptim i jetës atë kohë.

Sigurisht, por nuk e ka fshehur sidoqoftë. Gjerasimi në libër tregon, për shembull, se si po kalonin diku dhe kapadani jep urdhër që të merrnin katër qengja. I morën, i rropën, i poqën. U merrnin fshatarëve. Aty është një univers i tërë zakonesh dhe në këtë theshë: nuk kemi asnjë piktor kaq të ndershëm. Dhe, më




FIG.4. - Surrealizmi Socialist-FR




FIG.1. - gjuha pamore POLIS



Gëzim Qendro



vjen keq, por piktorët e realizmit socialist duhej të skuqeshin nga ky realizëm. Ky është realizmi. Prandaj unë kam krijuar termin surrealizëm socialist, sepse realizmi është ky i piktorës së Spiro Xegës. S'ka si të ketë qenë ai tjetri, kur çdo gjë aty ishte skenë, ishte teatër.

Unë, për fat të mirë, e mbajta librin "Heronjtë janë të uritur" 7 vjet në dorë, nuk e nxirrja. Dhe doli dikë në fund, një libër që ma dha një studium amerikan. Aty, në një moment, Sevasti Qirjazit motra e Gjerasimit tregon një episod shumë interesant lidhur me kaçakët që i kishin mbajtur peng të vëllanë. Gjatë kohës kur e kishin peng dhe prisnin paratë prej tij, kaçakët nxehnin gozhdë e ia hidhnin Gjerasimit kur flinte. Deri këtu shkoi.

- E kishin rrëmbyer Gjerasimin për para.
Po. Për 500 lira. Ajo është një histori interesante e tëra, sepse është dikush tjetër që ka përfutur më shumë se vetë Shahini, por nuk dua të merremi tani me atë histori. Të kthehem të tregimi i Sevastisë: pasi kaçakët e kishin liru Gjerasimin, siç tregon Sevastia, një ditë troket dera dhe disa burra të armatosur rëndë i thonë se donin të takonin Gjerasimin. Ishin bërë sakaq dy përpjekje për ta vrasë pasi ishte liru dhe pasi ishte hapur edhe shkolla. Sevastia duke dëshiruar se kishin dashur dy herë ta vrisnin, nuk dëshironte linte burrat e armatosur. Por Gjerasimi po kalonte në oborr dhe i thotë: lëri të hyjnë. E motra e cuditur që ata përfqohen me njëri-tjetrin e pyet se cilët ishin. Janë ata të çetës që më morën peng, i përgjigjet. Ata, kur iken i thanë: Kush të prek ty, ka punë me ne. Kush të prek ty dhe shkollën.

- E keni shumë të bukur atë momentin kur donin ta vrisnin Gjerasimin dhe diskutonin me njëri-tjetrin.

E patë çfarë barbarie? Ta vrasim këtu, se kush rri e mban deri te lumi, ishte diskutimi. Dhe e shpëtoi ai që tha: ju e keni ushgyer do humbisni gjithë atë që i keni dhënë për të ngrënë nëse e vrisni. Kjo e shpëtoi, pra një shpirt praktik perfekt. Por, këta njerëz që kishin logjikuar me kaq lehtësi për jetën e tij, duan ta mbrojnë tani. Unë nuk kam fshehur asgjë. Çfarë kam gjetur e kam thënë. Isha i bindur, nëse gjeja dhe dikë pozitive duhej të thënë dhe ajo. Se historia nuk është bardhezi. Pra kaçakët nuk ishin veç të këqij. Në një moment, si duket, ata u ndërgjegësuan dhe bënë dikë të mirë. Nuk ishin vetëm barbarë, analfabetë, të pagdhundur. Ndaj i shova librit dhe gati 15 faqe, për të qenë i ndërshej me ta.

- Në të vërtetë, ata ishin kompleksë.
Edhe ajo që thotë Sevastia, lidhur me mbrojtjen që i ofronjë Gjerasimit, mund të shiet me dyshim, por besoj se është e vërtetë. Fundja ajo i urrente, sepse prej tyre vdiq i vëllai. Ai mori tuberkulozin gjatë muajve kur ishte peng. Sevastia e dinte që ai ishte i sëmurë, që

nuk e kishte të gjatë dhe nuk besoj se ajo do t'i tregonte në dritë pozitive disa persona të cilët nuk kishte asnjë arsye t'i donte.

- Autori amerikan të cilin e përmendët, çfarë theksonte?

E keqja është se ne, dokumentet toma nuk i kemi këtu. Ato dokumente kanë përfunduar në Harvard, në Bibliotekën e dorëshkrimeve të Harvardit. Nuk e di si kanë përfunduar atje. Po flas për kujtimet e Sevasti Qirjazit. Ato janë atje. Dorëshkrimet e rralla. Autori amerikan i ka gjetur dhe ka bërë një studim për Gjerasimin, një studim 360 gradë. Madje kishte shkruar deri në fshat, në Popqishtë që është fshati i Shahinit. Kishte takuar një mbesë të tijen, kishte bërë vërtet një studim të jashtëzakonshëm.

- Ku jep gjithë këto detaje.
Po. Unë mësova shumë nga kërkimet e mia. Aq sa kur e mbarova librin tim, gati më erdhi keq, sepse me ta mbyllur unë nuk i kthehem më një libri. Por, duke shkruar në arkiva, duke lexuar, mësova shumë gjëra që nuk i dija. Pra, kur shkruan një libër nuk është se ti thiesht u tregon të tjerëve, por mëson për vetë shumë. Është një proces vërtet shumë interesant.

- E vërtetë. Kushdo që e lexon librin, ka një rishikim të historisë, të jetës sonë, të së shkuarës sonë. Ju nisenin një tablo, por hapet një univers i tërë.

Pikërisht.
- Do të kalojmë te libri "Arkeologjia e mëngjesit" (fig.3). Një kontribut mbi njërin nga piktorët më të njohur të Kosovës, Rexhep Ferrin që është një nga piktorët më simbolikë të Kosovës.

Përfshim. Përveç miqësisë që kemi, dhe unë kam shumë kënaqësi kur e takoj, Rexhepi ka një dimension kulturor që shumë pak artistë e kanë. Artistët pamorë duke qenë të mbyllur, duke ndënjur vetëm, zakonisht nuk janë shumë komunikues. Sigurisht që ata studiojnë, është normale, por Rexhepi shumë më tepër, ka shkruar 14 ose 15 romane.

... dhe piktura e tij është shumë origjinale. Ka krijuar një tipologji të tijen. Unë e quaj humanoid që ecën. Është nga rastet tipike të piktorës ekzistencialiste. Në fakt ishte i gjithë brezi i tyre që kishin të bënin me të. Ka qenë edhe një lloj eskapizmi (ikje nga realiteti) mendoj. Shteti jugosllav u krijoi një hapësirë që këtu ne nuk e kishim. Ata mund të shëtisnin. E vetmja gjë që nuk duhej të prekin ishte kombi. Pra, nuk mund të flisnin shumë për kombin shqiptar, megjithëse ata kanë bërë tema duke i ardhur rrotull me kujdes. Gjithashtu nuk duhej të merreshin me politikë.

- Studimet i bënin në Zagreb, në Lublljanë...
Ferrin ka studiuar në Beograd, në një akademi shumë të mirë. Jam duke bërë dhe një studim tjetër, jo për Rexhepin, por për pararojat shqiptare. Dhe më bën përshtypje, është shumë e cuditshme, që pararojat shqiptare janë unike në botë, besoj. Pararojat artistike, moderniste. Le të shohim p.sh. pararojen e Kosovës së kohës së Jugosllavisë. Zakonisht, pararoja ka një ushtri pas. Ky është koncepti, pra. Shumë ushtarak si term. Këta në fakt, janë një pararojë pa ushtri. Si dhe nuk kanë pasur paraardhës, këta kanë qenë të vetmit. Studiuam dhe u kthyen. Nuk kishin një traditë përpara. Nuk kanë një armik. Pra një ushtri që s'ka armik. Normalisht, moderniteti ka armik.

- Modernët thyejnë disa norma.
Po. Për shkak të kohës dhe historisë që ka Kosova, ata nuk kanë pasur një traditë të artit pamor për t'u rrëzuar. Këta e filluan. Tjetër interesante është që, moderniteti, pra koha moderne, kapitalizmi krvesisht, krijon dy modernitete brenda në konflikt me njëri-tjetrin. Njëri është teknologjik, që prodhon kërcim, prodhon mirëgenien dhe tjetri është estetik. Dhe, të dy këta përplasen gjithmonë. Psh. të gjithë artistët elitarë janë tallur gjithmonë me kërcim. Por kush e prodhon kërcin? E prodhon moderniteti teknologjik.

Pra, duke mos qenë akoma shoqëria kosovare një shoqëri ku këto dy modernitete të kishin hyrë në luftë, artistëve kosovarë u mungonte ky konflikt që është një konflikt shumë i rëndësishëm.

Një konflikt tjetër po aq i rëndësishëm, ka të bëjë me atë që moderniteti drejtohet kundër vlerave të klasës së mesme, filistinizmit borgjez, sic e quajnë artistët, francezët kryesisht, Pol Valeri e pastaj me radhë. Kosovarët nuk e kishin klasën e mesme. Klasa e mesme që po e bënin dalëngadalë ish in ata vetë. Pra, është një modernitet në ishull. Shumë interesante si dukuri kulturore. Po ua thosha një ditë, dhe ata nuk ishin shumë të lumtur. Por unë do të doja ta çoja deri në fund se tek e fundit ka ndodhur. Në rastin e studimit për Rexhepin nuk jam marrë shumë me këtë gjë. Vetëm 10 faqe janë Shqipëria dhe Kosova. Për pararojen aty nuk flas dhe ajo është pjesa që do i shtohet librit.

- Aty keni një ide shumë interesante. Mungesa e identitetit evropian të shqiptarëve në fushën e artit pamor. Kjo vjen nga gjithë shkaqet historike që ju i shpjegojnë.
Në kemi humbur, në fakt, është sikur të jenë shtruar disa bankete në të cilat ne nuk jemi kurrë.

- Jo se s'na kanë ftuar, s'kemi vend aty.
S'na kanë ftuar se kanë menduar që ne nuk duam të jemi. Në fakt, nuk është se ne s'kemi dashur. P.sh., shqiptarët që vajtën në Venecik hapen Akademinë e shqiptarëve, të parën...




FIG 2 - HERONJTE JANE TE URITUR




FIG 3 - Arkeologjia e Mëngjesit

- Pas rënies së Skënderbeut.
Në 1474. Është nganjëherë për të ardhur keq se, me siguri një pjesë do të kishte dashur ta bënte, të ishte në ato bankete. Jo të gjithë, sigurisht. Jemi vonë, padyshim. Por, me kënaqësi vë re që shumë gjëra po ndryshojnë. Në po rikuperojmë, me gjithë traumat që lë mungesa... Shoh një brez që, po jap një shembull me shkollën ku jap mësim, një brez pra që nuk ka ndryshim me studentët e shkollave jashtë. Në kam studiuar vetë jashtë, shkoj herë pas here në universitete të huaja, dhe shoh që nuk ka asnjë ndryshim midis studentëve tanë dhe studentëve jashtë qëftë në lidhje me teknologjinë, qoftë me lirinë e shtyllës, gjithçka.

- Informacioni që marrin...
Absolutisht gjithçka dhe kjo të jep kënaqësi sigurisht. Deri edhe mjediset janë të krahasueshme. Se u bënë 20 vjet që jap mësim. Krahasoj mjediset ku kam dhënë mësim fillimisht dhe ku jap tani. Janë mjedisë normale evropiane.

- Po vërtet, mjedisin fizik është evropian.
Ndjehesh mirë. Se në hyjmë në hapësirë por dhe hapësira hyn brenda nesh. Kështu që, në këtë rast, ky lloj dinjiteti që ka marrë hapësira përthshet si dinjitet edhe i yni. Qoftë i pedagogëve që japin mësim, qoftë i studentëve, etika është tregulluar mjaft.

- Unë do të doja të kaloja te një tjetër libër juaj shumë i rëndësishëm, të cilin e presim në shqip se është akoma frëngjisht, "Le Surrealisme socialist" (fig.4). Ju e filluat si doktoratë në universitetin Paris 8 dhe pastaj e botuat si libër me nëntitullin "L'Autopsie de l'utopie" dhe keni vënë në kopertinë një tablo shumë interesante të Enkelejd Zonjës.

Pjesërisht, tabloja është më e madhe. **"Termi surrealizëm socialist, ndërsa jemi mësurat me termin realizëm socialist, është le të themi një invencion i juaj."**

Kjo kërkim një shpjegim shumë të gjatë, por unë do të përpiqem ta përmbledh: Ne zakonisht mendojmë në terma binarë. Dmth., feja - ateizmi, errësira-drita, mungesa-pasuri. Është ajo që e quajmë la diferencë, pra ti e gjen errësirën ose dritën nga diferencë mes tyre. E-në ti e dallon se është ndryshe nga A-ja, C-ja nga T-ja, por në vetvete një E e C'raj është? S'është asgjë. Kështu kjo diferencë krijon një kuptim. Duke i vendosur së bashku gjërat e ndryshme krijojnë një sinerji, krijojnë morfema, sintagma pamore... Në fakt e gjithë historia e filozofisë evropiane, logocentrizmi, është i mbështetur mbi këtë model.

- Mbi këtë kundërvënien.
Po. Ndërkohë Derrida thotë që nuk ka metafizikë të pranisë, por të mungesës së saj. Në fund fare del që, siç qoftë Hajdegeri, qoftë gjithë poststrukturalistët thonë, e vetmja gjë që

kemi në dorë dhe që mund ta shohim, ta diskutojmë është një tekst, asgjë më tepër. Në këtë mënyrë, gjithë totalitarizmit ata i heqin bazën legjitimuese. Pra, në qoftë se ti beson në dikë, siç thotë dhe Kierkegaardit kjo është puna jote. Ajo që ti di me siguri është që ti beson. Por metafizikën e pranisë, d.m.th., dikë jashtë tekst-it që vërteton atë që është shkruar në tekst, nga e di ti?

Në këtë kuptim bie do arsyë për të vrrarë të tjerët sepse ata nuk besojnë tekstin tënd. Sepse ti tekstin ke, çfarë ke përtej? Pra, teksti është i strukturuar. Teksti është ajo që thotë Derrida se është një ngjarje, l'événement. Po, përtej ngjarjes çfarë ka? Është ajo që e quan, suplementariteti i shenjes, gjurma.

Surrealizmi socialist është interpretimi i kësaj gjurme.

Gjithë historia e metafizikës është një kërkim të një gjende. Një gjendë është një parim organizues prej të cilit rrjedh gjithë dija më pas:

Zoti është në fillim dhe këtu ka një parim organizues.

Parimi organizues është, gjithashtu, fakti që historia ka një ADN. Në fillim është komuniteti primitiv, skllavopronarizmi e me radhë, feudalizmi, kapitalizmi, socializmi si fazë e ndërmjetme dhe komunizmi. Në këtë kuptim ka një ADN dhe pastaj ka një agjent mesianik, që është proletariati dhe ka një mjet që është revolucioni. Pra, gjithçka është e parathënë, e ka një qendër.

Por, çfarë ndryshimi ka mes dy rasteve? Këtu është Zoti dhe këtu është proletariati? Të dyja janë të paracaktuara. Pse janë vrrarë armiqitë e komunizmit? Sepse nuk besonin që komunizmi do vijë. Ishin të ngjashëm pra komunizmi dhe feja. Pikërisht sepse janë të ngjashëm prandaj dhe asgjësuan njëri-tjetrin, urryesh njëri-tjetrin.

- E gjithë kjo është tema, le të themi, e librit tuaj... Termini "Surrealizëm socialist" ju e përdorët për herë të parë kur ishit drejtor i Galerisë së Arteve dhe kuruat (1999), ekzistencën me këtë titull. Mësu me kujtohet debati i madh që shpërthoi në atë kohë...

Po u bëra armik publik në atë kohë... **-Pakush e kuptoi qëllimin e vërtetë të ekzistencës.**

Është e vërtetë, u keqkuptua. Gjë që tregoi se ekzorizimi i fantazmës së komunizmit ose Enverit nuk kishte ndodhur. Fantazma ishte brenda u shfaq menjëherë dhe me t'u shfaqur u trëmbën. Nuk kishte kënduar gjeli që të zhdukej fantazma. Pra ishim akoma në natën ku herë pas herë fantazma shfaqej. Dhe të dy palët u distancuan se kishin frikë se mos infektoeshin ose mos lidheshin me të. Disa për nostalgji, padyshim, disa për komplekse, disa dhe për urrejtje të mirëfilltë pse jo.

-Dhe pati në atë kohë një shpërthim.
Shpërthim ishin shumë emocionale, pa kulturë fare. Unë shkrova një tekst, dy faqe, ku sqarova metafizikën e pranisë dhe askush nuk u mor me të, nuk e lexoi askush. Të gjithë thanë, ky është një neokomunist, është një nostalgjik. Sigurisht tregonte edhe nivelin e kohës ky reagim.

-Sot libri juaj botohet me një qetësi të madhe, në bazë të interpretimit që ju i bëni artit.

Po, për fat të mirë.
-Të gjitha këto analiza dhe studime që bëni, janë shumë interesante dhe unë besoj dhe shpresoj që të vazhdoni me këtë pasionin të pamposhur. Por gjithashtu jeni përkthyes i njohur tashmë. Këni përkthyer libra që lidhen me imazhin sikurse "5 fytyrat e modernitetit", "Arti dhe mjeshtria e bukurisë", "Fuqia e imazheve" etj. Dhe ky është një pasion tjetër, besoj, që ka rrembyer shumë prej nesh në këto vjet.

Unë i detyrohem shumë përkthimit, siç më kishte të shkruaj. Në kuptimin që përkthim, sic dhe ju e dini, të detyron ta marrësh një frazë e t'i rikthehesh 4-5 herë, derisa të gesh variantin e duhur. Edhe për një fjalë të detyron të kërkosh. Të pasuron fjalorin jashtëzakonisht shumë, frazeologjinë se ndryshe është ta lexosh një libër dhe ndryshe ta përkthesh. Dhe, në këtë kuptim, mendoj se më ka ndihmuar shumë për të shkruar. I ndjehem borxhi.

-Mëqë jemi në këtë temë: ka shumë fetishe të cilat, unë personalisht mendoj se janë nga mosdija ose nga mosleximi. Pra, dëgjimë shpres që thonë se dikur kishte përkthime, se shqiptarët merrnin në dorë përkthime të mira më parë. Kjo është krejtësisht e pavërtetë sipas meje. Nuk e di a keni dhe ju të njëjtin mendim?

Ka disa përkthime të vjetra që unë vërtet i vlerësoj shumë. Për shembull, "Papa jeshil". Është një përkthim i jashtëzakonshëm. Aty Petro ka bërë një rrekullori, ose "Zoti president" po ashtu. Pra ka disa libra që edhe sot po t'i lexosh s'ke ç'tu ndryshosh. Sidogoftë, mendoj se përkthyesit e asaj kobe kanë bërë maksimumin dhe duhen nderuar, respektuar, por nuk duhen fetishizuar dhe kjo duhet të jenë. Unë e shoh me shumë optimizëm atë që po ndodh sot, sepse nga '98, kur kam filluar përkthimin dhe deri sot, shoh një ndryshim të jashtëzakonshëm. Mjaft emra të rinj përkthyesish kanë hyrë me dinjitet. Nganjëherë përballen me libra të vështirë, shpesh ia dalin, nganjëherë jo.

Nga ana tjetër, ka dikë për të cilën unë kam dyshuar herë-herë: a mundet shqipja ta përballojë përkthimin? Kam arritur në konkluzionin që po, mundet! (14 Maj 2016)



MAK ALBANIA HOTEL

31 Dhjetor 2018

20:30



PJESË E
KASTRATI GROUP



MAK ALBANIA HOTEL

Nata e ndërrimit të viteve!

- ~ Menu me 7 raunde dhe pije të përfshira
- ~ Muzikë dhe Argëtim Live nga këngëtarët Altin Goci, Marsela Çibukaj, grupi Ali Pashe Tepelena dhe cirku i Tiranës
- ~ Gëzuar Vitin e Ri me "Moët Chandon" dhe fishekzjarre në tarracën e Infinity Bar
- ~ Shorte me dhurata



**Për prenotime deri me datë 20 Dhjetor, për cdo 6 persona i 7-i falas
Ofertë speciale akomodimi për muajin Dhjetor 75 euro çifti**

Terma dhe kushte

Menu speciale për fëmijë me 50% zbritje për moshën 5-12 vjeç
Fëmijët 0-5 vjeç falas
Parkim i garantuar pa pagesë



+355 4 2274 707



+355 69 20 25205



@ sales.tirana@makalbania.com

